

With funding from

 Austrian
Development
Cooperation



ANALIZA VJETORE E PERFORMANCËS 2022

DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE
FALAS

Adresa: Rruga "Jordan Misja",
Godina nr.3 Tiranë



MINISTRIA E DREJTËSISË DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

ANALIZA VJETORE E PERFORMANCËS VITI 2022

Në mbështetje të shkronjës "b" të nenit 8 të ligjit nr. 111/2017, "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti", u hartua raportimi për vitin 2022.

Ky raport përmbledh detyrimet funksionale dhe obligimet që rrjedhin nga ligji nr. 111/2017, politikat dhe prioritetet e përcaktuara nga Ministri i Drejtësisë, dokumentat strategjikë në të cilati institucioni është i përfshirë, si dhe prioritetet dhe objektivat e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas për vitin 2023, të ndara respektivisht sipas krerëve.

Botimi i këtij raporti u mundësua me mbështetjen e Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP) në kuadër të Projektit për "Zgjerimin e shërbimeve të ndihmës juridike falas për gratë dhe burrat në Shqipëri" financuar nga Bashkëpunimi Austriak për Zhvillim (ADC) dhe zbatuar nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP) në partneritet me Ministrinë e Drejtësisë.

Tabela e Përmbajtjes

1. Funksionimi me kapacitet të plotë i Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas	7
1.1 Propozimi për ndryshimin e strukturës së DNJF me qëllim shtimin e numrit të Qendrave të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore	8
2. Ndhma Juridike Parësore	11
2.1 Qendrat e ofrimit të shërbimit të ndhmës juridike parësore.....	11
2.1.1 Kalimi nën administrim të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas të 2 nga 8 qendrat e hapura me mbështetjen e UNDP	12
2.1.2 Hapja e 4 qendrave të reja të ofrimit të shërbimit të ndhmës juridike parësore.....	12
2.1.3 Zhvendosja e Qendrës së Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Fier dhe Gjirokastrë pas mbylljes së sporteveleve ADISA (ambiente në të cilat qendrat ushtronin veprimtarinë).....	14
2.2 Lidhja e marrëveshjeve të bashkëpunimit me Klinikat e Ligjit pranë Institucioneve të Arsimit të Lartë me qëllim ofrimin e shërbimit të ndhmës juridike parësore	15
2.2.1 Angazhimi i Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas në kuadër të zhvillimit të trajnimeve për studentët	16
2.2.2 Zhvillimi i praktikave 2 mujore të punës pranë Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas dhe Qendrave të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore në Tiranë, Durrës dhe Shkodër.	17
2.3 Autorizimi i Organizatave Jofitimprurëse të autorizuara nga Ministri i Drejtësisë.....	17
2.4 Të dhënat statistikore për vitin 2022, ndhma juridike parësore.....	20
3. Ndhma juridike dytësore	23
3.1 Procesi i lidhjes së kontratave me avokatët.....	23
3.2 Trajnimi i avokatëve pjesë e listës	24
3.3 Ecuria e vendime për pranimin e ndhmës dytësore.....	24
3.4 Caktimi i Avokatëve.....	28
3.5 Një konkluzion i të dhënave statistikore me një qasje krahasuese:.....	29
3.6 Problematika lidhur me ndhmën juridike dytësore:.....	30
4. Monitorimi i cilësisë së ofrimit të ndhmës parësore dhe dytësore	30
4.1 Monitorimi i cilësisë së ofrimit të ndhmës parësore (Janar-Dhjetor 2022).....	30
4.1.1 Analizë e raporteve të monitorimit të kryera në Qendrat e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore	31
4.1.2 Ecuria e kryerjes së monitorimeve të qendrave	32
4.1.3 Konkluzione dhe Rekomandime nga Monitorimet e Qendrave të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore	34
4.2 Monitorimi i cilësisë së ofrimit të shërbimit të ndhmës juridike dytësore	35
5. Ndërgjegjësimi i publikut mbi sistemin e ndhmës juridike	38
5.1 Zhvillimi dhe pjesëmarrja në takime/aktivitete ndërgjegjësuëse	38
5.2 Zhvillimi i intervistave televizive në kuadër të promovimit të sistemit të ndhmës juridike, edukimit ligjor të publikut	53
5.3 Nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet në nivel qendror dhe vendor si dhe me organizata jofitimprurëse që operojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të qytetarëve.	54

6. Trajnimi i ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe dytësore.....	55
6.1 Bashkëpunimi me Caritas Shqiptar (Trajnimi i ofruesve të ndihmës juridike parësore).....	55
6.2 Sa i përket trajnimit të ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike parësore.....	56
6.3 Sa i përket trajnimit të ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike dytësore	56
7. Kontribute dhe raportime të DNJF-së në kuadër të proceseve strategjike	57
7.1 Angazhim i DNJF në kuadër të Strategjisë për Edukimin Ligjor të Publikut (SELP).	57
7.2 Angazhim i DNJF në kuadër të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë (SND).	59
7.3 Angazhim i DNJF në kuadër të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit dhe Planit të Integritetit	60
7.4 Angazhim i DNJF në kuadër të Strategjisë së Drejtësisë për të Miturit (SDM).....	61
7.5 Kontribut i DNJF ne kuader te angazhimit ne Planin e Veprimit per Partneritet dhe Qeverisje te Hapur (OGP).....	62
8. Angazhimet e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas në kuadër të procesit të Integritetit Evropian dhe Raportimeve Ndërkombëtare	62
8.1 Kontribut dhe raportime në kuadër të procesit të Integritetit Evropian për progresin e arritur mbi forcimin e aksesit në drejtësi dhe shërbimet ligjore falas:.....	62
9 Raportime ndërkombëtare:	63
9.1 Kontribut i përditësuar i DNJF lidhur me zbatimin e Konventës së OKB-së “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave” CEDA”	63
10 Kontribut në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Para-anëtarësimit IPA:	63
10.1 Kontribut në kuadër të IPA II.....	63
11. Bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare mbështetëse (UNDP/ OSFA/CLE)	64
11.1 Bashkëpunimi me UNDP	64
11.1.1 Hapja e qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore	64
11.1.2 Zhvillimi i trajnimeve për ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe dytësore	65
11.2 Bashkëpunimi me OSFA.....	65
11.2.1 Projekti “Angazhimi pro-aktiv i paraligjorëve në kuadër të rritjes së aksesit të kategorive vulnerabël në shërbimet e ndihmës juridike të garantuar nga shteti” (Korrik 2021-Prill 2022)	65
11.3 Bashkëpunimi me CLE.....	66
11.3.1 Mbështetja e Centre For Legal Empowerment sa i përket funksionimit të platformës juristonline.al	66
11.4 Kërkesë për mbështetje me qëllim forcimin e sistemit të ndihmës juridike falas	66
12. Prokurimet	67
13. Të dhëna buxhetore viti 2022.....	68
14. Arritjet e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas për vitin 2022, vështrim krahasimor me vitin 2021	71
15. Plani i Punës Janar-Dhjetor 2023, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas	75

1. Funksonimi me kapacitet të plotë i Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas

Drejtorja e Ndhmës Juridike Falas, është person juridik publik nën varësinë e Ministrit të Drejtësisë, organizimi i brendshëm i së cilës është miratuar nga Kryeministri, me Urdhër nr. 59, datë 25.03.2019 "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë Ndhmës Juridike Falas", i ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Falë punës dhe arritjeve përgjatë viteve 2019-2022, Drejtorja e Ndhmës Juridike Falas ka kaluar si Institucion qendror i grupit të parë, zyrtarizuar me Vendimin nr. 443, datë 29.6.2022, "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 187, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave" "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në disa institucione të administratës publike", i ndryshuar.

Përgjatë vitit 2022, është bërë i mundur plotësimi i 9 pozicioneve vakante, përkatësisht:

- Punonjës pjesë e shërbimit civil (5): 4 Specialistë, Drejtorja e Mbikëqyrjes së Standardeve të Ofritit të Shërbimit të Ndhmës Juridike si dhe 1 Specialist, Burime Njerëzore.
- Punonjës të Qendrave të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore (pjesë e strukturës së DNJF) sipas Kodit të Punës: 4 Punonjës me trajnim të posaçëm (2 Qendra Durrës, 2 Qendra Shkodër)

Pozicionet e mbetura vakante për vitin 2022, janë përkatësisht:

- Punonjës pjesë e shërbimit civil (2): 1 Drejtor, Drejtorja e Mbikëqyrjes së Standardeve të Ofritit të Shërbimit të Ndhmës Juridike si dhe 1 Specialist, Drejtorja e Mbikëqyrjes së Standardeve të Ofritit të Shërbimit të Ndhmës Juridike.
- Punonjës të Qendrave të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore (pjesë e strukturës së DNJF) sipas Kodit të Punës: 1 Punonjës me trajnim të posaçëm (Qendra Lushnje).

Drejtorja e Ndhmës Juridike Falas i është drejtuar në mënyrë të përsëritur Departamentit të Administratës Publike me qëllim shpalljen e pozicioneve të lira në faqen zyrtare të DAP. (Shkresat drejtuar DAP me nr. 1684 prot., datë 25.08.2022, si dhe nr. 1562 prot., datë 19.07.2022) Përgjatë vitit 2022, vendet vakante nuk janë shpallur në faqen zyrtare të DAP.

1.1 Propozimi për ndryshimin e strukturës së DNJF me qëllim shtimin e numrit të Qendrave të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore

Konsolidimi i sistemit të ndihmës juridike parësore por edhe puna intensive e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas në promovimin e sistemit ka passjellë një rritje progresive të numrit të qytetarëve përfitues nga shërbimet e të ndihmës juridike parësore nga **23 raste për vitin 2019**, në **4191 raste për vitin 2020**, në **8153 raste për vitin 2021** si dhe **7616 raste për vitin 2022: Total: 19.983 raste**.

Gjithashtu, për herë të parë në rajon u mundësua një platformë online e dedikuar shërbimeve ligjore falas (**juristionline.al**) si dhe vendosja në dispozicion i numrit të gjelbër 08001010: Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Fondacionin Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, për të garantuar aksesin e qytetarëve nëpërmjet ndihmës juridike falas edhe në kushtet e pandemisë.

Sa i përket ndihmës juridike dytësore, nëse në vitin 2019, kanë rezultuar në listën e avokatëve ofrues të ndihmës juridike të garantuar nga shteti, **60 avokatë në vitin 2019; 70 avokatë në vitin 2020; 124 avokatë në vitin 2021**, ndërsa **në vitin 2022 janë kontraktuar 157 avokatë**. Rritja progresive e interesit të avokatëve për t'u bërë pjesë e ndihmës juridike dytësore është një tregues i qartë që sistemi i ndihmës juridike dytësore është funksional dhe i gatshëm për qytetarët në nevojë.

Ky fakt rezulton dhe nga numri i kërkesave për ndihmë juridike dytësore (*përfaqësim me avokat të garantuar nga shteti në gjykatë*). Vetëm përgjatë vitit 2021, kanë përfituar ndihmë juridike dytësore dhe përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore 671 persona (*nga 849 vendime gjyqësore në total*), një **7-fishim i rasteve të trajtuara krahasimisht me vitin 2020 (181 raste në total)**. Për vitin 2022, janë administruar **1030 vendime** duke e çuar numrin në total në **2060 vendime**.

Numri i vendimeve gjyqësore të administruara për ndihmë juridike dytësore, përkthehet drejtëpërdrejtë në kosto për buxhetin e shtetit si dhe në rritjen e numrit të përfaqësimeve gjyqësore të cilat duhet të mbikëqyren për nga cilësia e shërbimit, nga Drejtoria e Mbikëqyrjes së Standardeve të Ofrimit të Shërbimit të Ndhmës Juridike, pjesë e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas.

Nuk mund të mos përmendim gjithashtu dhe angazhimin e Drejtorisë në kuadër të **Strategjive dhe Raportimeve Ndërkombëtare** në kushtet kur Aksesin në Drejtësi është një komponent shumë i rëndësishëm i sanksionuar nga shumë akte ndërkombëtare. Përmendim këtu angazhimin në kuadër të Strategjisë për Edukimin Ligjor të Publikut (SELP); Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë (SND); Strategjinë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2020 (SNKK); Strategjinë e Drejtësisë për të Miturit (SDM); Planin e Veprimit për Partneritet dhe Qeverisje të Hapur (OGP); Planin Kombëtar të Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve 2021-2025 etj.

Sa më sipër, pavarësisht faktit se Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas është i krijuar rishtazi, efektiviteti dhe produktiviteti i skemës së ndihmës juridike të garantuar nga shteti ka patur një impakt mëse pozitiv në kuadër të përmushjes së misionit madhor *"Garantimit të aksesit në drejtësi për të gjithë qytetarët si një e drejtë themelore me karakter kushtetues"*.

Struktura aktuale e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, është miratuar me Urdhrin e Kryeministrit nr. 59 datë 25.03. 2019 *"Për miratimin e strukturës dhe organikës së Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas"* i ndryshuar me një numër total prej 25 punonjësish.

Proceset e sipërcituara të punës tregojnë qartazi një ngarkesë të lartë të punës, ngarkesë e cila nuk është në raport me numrin e punonjësve të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas. Si rrjedhojë, me qëllim rritjen e efektivitetit dhe efikasitetit në punë, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, me shkresën me nr. 1757 prot., datë 20.09.2022, si dhe shkresën me nr. 162 prot., datë 18.01.2023, ka propozuar ndryshimin e strukturës së DNJF-së duke shtuar numrin e punonjësve nga 25 punonjës në 39 punonjës në total.

Arsyet e kërkesës për ndryshimin e Strukturës së DNJF-së.

1. Me Vendim nr. 443, datë 29.6.2022, pika 1/3 "*Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 187, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave*", "*Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në disa institucione të administratës publike*", të ndryshuar Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas falë punës dhe arritjeve përgjatë viteve 2019-2022, ka kaluar si Institucion qendror të grupit të parë, në varësi të Ministrave të Linjës;
2. Zbatimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit (*Marrëveshja Shkurt 2022-Shkurt 2023*) me nr. 763/1 prot., datë 15.02.2022 midis UNDP dhe Ministrisë së Drejtësisë ku ndërmerret angazhimi jo vetëm për vijimin e mbështetjes së qendrave aktuale por edhe për hapjen e 4 (*katër*) Qendrave të reja të shërbimit të ndihmës juridike parësore, me kushtin që MD të kalojë si pjesë të strukturës së DNJF 2 (*dy*) nga Qendrat e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore të hapura më mbështetjen e UNDP dhe në vijim për kalimin rast pas rasti të qendrave të tjera;
3. Harta e re gjyqësore (*Këshilli miratoi raportin vlerësues përfundimtar të Grupit Ndërinstitucional të Punës mbi riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave*) parashikon 12 gjykata të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, dhe vetëm 1 gjykatë apeli për juridiksionin e përgjithshëm dhe 1 për atë administrativ. Mbyllja e gjykatave në rrethe lind nevojën që qytetarët në këto rrethe të kenë paqartësi për procedurat që duhet të ndjekin si dhe institucionet ku duhet të drejtohen. Si rrjedhojë me qëllim garantimin e aksesit në drejtësi lind nevoja që në ambientet e gjykatave që do të mbyllen të jetë funksionale 1 (një) qendër e shërbimit të ndihmës juridike parësore për të informuar të gjithë individët të cilët kërkojnë një informacion mbi procedurat dhe institucionet ku duhet të drejtohen për zgjidhjen e problematikës së tyre;
4. Nga analiza vjetore e bërë përgjatë vitit 2021, vëmë re një shtim të rasteve si për ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore ashtu edhe për numrin e vendimeve gjyqësore me objekt ndihmën juridike dytësore. Ky numër në rritje do të passjellë nevojën e shtimit të stafit pranë strukturave të DNJF për qëllim vlerësimin e shërbimit të ofruar nga avokatët dhe ekspertët dhe deri në procesin e likuidimit të tyre;
5. Rritja e numrit të ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe dytësore në Tiranë dhe në rrethe sjell nevojën e rritjes së stafit të DNJF për mbikëqyrjen në terren të cilësisë së shërbimit;
6. Rritja e numrit të Qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore sjell nevojën për monitorimin e vazhdueshëm të prezencës së punonjësve si dhe cilësinë e ofrimit të shërbimit nga qendra kundrejt qytetarëve duke krijuar indikatorë të matshëm mbi cilësinë e ofrimit të shërbimit dhe promovimin në vijimësi të shërbimit me qëllim që shërbimi të jetë i njohur dhe efektiv për të gjithë qytetarët.

Përmes ndryshimit të Urdhrit të Kryeministrit nr. 59 datë 25.03. 2019 "*Për miratimin e strukturës dhe organikës së Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas*" nëpërmjet riorganizimit të strukturës së Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas me qëllim administrimin e stafit në funksion të arritjes së objektivave, propozohet krijimi i 2 sektorëve brenda një Drejtorie me shtesë në pozicionin "*Përgjegjës Sektori*", shtesë punonjës për Qendrat e Ndihmës Juridike Falas si dhe rishpërndarjen e re të detyrave funksionale dhe përgjegjësi të punonjësve, sipas skemës organizative si vijon:

POZICIONI	KATEGORIA	NUMRI
1 DREJTOR I PËRGJITHSHËM	II-a	1
2 DREJTORIA E ZBATIMIT TË POLITIKAVE DHE ADMINISTRIMIT TË NDIHMËS PARËSORE		18
DREJTOR	III-a	1
SEKTORI I ADMINISTRIMIT TË OFRUESVE TË SHËRBIMIT TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE		
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-b	1
SPECIALIST (Qendrat e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore)	IV-a	18
SPECIALIST-JURIST	IV-a	2
SEKTORI I ZBATIMIT TË POLITIKAVE, PROJEKTEVE DHE STRATEGJIVE		
SPECIALIST-JURIST	IV-a	2
3. DREJTORIA E MBIKËQYRJES SË STANDARDEVE DHE ADMINISTRIMIT TË NDIHMËS DYTËSORE		7
DREJTOR	III-a	1
SEKTORI I ADMINISTRIMIT DHE VLERËSIMIT TË DOSJEVE TË OFRUESVE TË NDIHMËS JURIDIKE DYTËSORE		
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-b	1
SPECIALIST-JURIST	IV-a	3
SEKTORI I MONITORIMIT TË OFRUESVE TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE DHE DYTËSORE		
SPECIALIST-JURIST	IV-a	2
4. DREJTORIA E FINANCËS, ARKIVIT DHE SHËRBIMEVE MBËSHTËTËSE		7
DREJTOR	III-a	1
SEKTORI I BUXHETIT DHE FINANCËS		
SPECIALIST-FINANCË/BUXHET	IV-a	2
SEKTORI I SHËRBIMEVE MBËSHTËTËSE DHE ARKIVIT		
SPECIALIST-BURIME NJERËZORE	IV-a	1
SPECIALIST-ARKIV/PROTOKOLLI	IV-a	1
SPECIALIST-IT	IV-a	1
MAGAZINIER	Klasa	1
TOTAL		39

2. Ndihma Juridike Parësore

Bazuar në nenin 13 të ligjit 111/2017, ndihma juridike parësore jepet nga:

- a) punonjësit me trajnim të posaçëm;
- b) organizatat jofitimprurëse të autorizuara;
- c) klinikat ligjore pranë institucioneve të arsimit të lartë.

Administrimi dhe promovimi i sistemit të ndihmës juridike parësore ka qenë një ndër prioritet kyçe të DNJF. Përgjatë kësaj periudhe DNJF ka mbajtur një komunikim dhe bashkëpunim të vazhdueshëm me ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike parësore si dhe me organizatat ndërkombëtare partnere si UNDP; OSFA apo EURALIUS me qëllim nxitjen e sistemit të ndihmës juridike parësore.

2.1 Qendrat e ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike parësore

Bazuar në kompetencën e caktuar në nenin 8, pika gj) DNJF administron, bazuar në urdhrin përkatës të Ministrit të Drejtësisë, qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore, në ambientet e gjykatave të rretheve gjyqësore ose në ambiente të tjera të përshtatshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi për administratën shtetërore.

Në kuadër të ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike parësore, DNJF ka vijuar me procedurat e hapjes së qendrave të ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike parësore në qytete të cilat, kanë më shumë nevoja për këtë natyrë shërbimi.

Për vitin 2022, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas administron 14 (katërmëdhjetë) qendra në qytetin e Tiranës, Durrësit, Fierit, Lezhës, Shkodrës, Lushnjes, Pogradecit, Gjirokastrës, Vlorës Dibrës, Kukësit, Korçës, Beratit dhe Elbasanit sipas tabelës si vijon:

Qendra	Hapur/Rivitalizuar	Vendndodhja	Mbështetës
Tiranë	Korrik 2021	Ministria e Drejtësisë	Buxhet Shteti
Durrës	Dhjetor 2020-UNDP Korrik 2022- Buxhet Shteti	Gjykata e Rr.Gj.Durrës	Buxhet Shteti
Fier	Shkurt 2021	Këshilli i Qarkut Fier (zhvendosur nga ADISA Fier)	UNDP/ADC
Lezhë	Dhjetor 2020	Bashkia Lezhë	UNDP/ADC
Lushnje	Shtator 2020	Bashkia Lushnje	Buxhet Shteti
Gjirokastrë	Dhjetor 2020	Pallati i Sportit, Bashkia Gjirokastrë (zhvendosur nga ADISA Gjirokastrë)	UNDP/ADC

Shkodër	Shkurt 2021-UNDP Korrik 2022- Buxhet Shteti	Gjykata e Rr. Gj. Shkodër	Buxhet Shteti
Pogradec	Tetor 2020	Bashkia Pogradec	UNDP/ADC
Vlorë	Mars 2021	Bashkia Vlorë	UNDP/ADC
Dibër	Shkurt 2021	Gjykata e Rr. Gj. Dibër	UNDP/ADC
Elbasan	Korrik 2022	Gjykata e Rr. Gj. Elbasan	UNDP/ADC
Berat	Korrik 2022	Bashkia Berat	UNDP/ADC
Kukës	Nëntor 2022	Bashkia Kukës	UNDP/ADC
Korçë	Dhjetor 2022	Drejtoria e Kujdesit Social, Bashkia Korçë	UNDP/ADC

Përgjatë vitit 2022 është bërë e mundur hapja e 4 qendrave të reja të shërbimit të ndihmës juridike parësore në Berat, Elbasan, Korçë dhe Kukës (në kuadër të marrëveshjes mes Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP) me mbështetjen financiare të Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim (ADC)

Përgjatë vitit 2022 është bërë i mundur kalimi nën administrim si pjesë e strukturës së institucionit të 2 qendrave hapura me mbështetjen e UNDP në Durrës dhe Shkodër (në kuadër të marrëveshjes mes Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP) me mbështetjen financiare të Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim (ADC)

Nga ana e DNJF janë ndërmarrë masat për lidhjet e marrëveshjeve "Për vendosjen në dispozicion të ambienteve pa kundërshpërblim për hapjen e Qendrave të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore" me institucionet ku janë vendour këto qendra si dhe rekrutimit të punonjësve me trajnim të posaçëm, sipas praktikës së konsoliduar të ndjekur përgjatë vitit 2020 dhe 2021, konkretisht:

2.1.1 Kalimi nën administrim të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas të 2 nga 8 qendrat e hapura me mbështetjen e UNDP

Urdhri nr. 136 i Ministrit të Drejtësisë, datë 11.4.2022 "Për kalimin nën administrim të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas të Qendrës të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore në Shkodër dhe Qendrës të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore në Durrës"

Është bërë i mundur regjistrimi i punonjësve të Qendrës Durrës dhe Shkodër si punonjës, pjesë e strukturës së Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, që prej muajit Korrik 2022

2.1.2 Hapja e 4 qendrave të reja të ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike parësore

Urdhri nr. 156 i Ministrit të Drejtësisë, datë 22.4.2022, "Për hapjen dhe kalimin nën administrim të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas të Qendrave të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore në Elbasan dhe Berat".

Urdhri nr. 363 i Ministrit të Drejtësisë, datë 12.7.2022 "Për hapjen dhe kalimin nën administrim të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas të Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore në Kukës dhe Qendrës të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore në Korçë"

QSHNJP BERAT

- Lidhur Marrëveshja e Bashkëpunimit "*Për vendosjen në dispozicion të ambienteve pa kundershperblim me Bashkinë Berat*" 1002/1 prot., datë 20.12.2021.
- Përfunduar procedura e përshtatjes së zyrës së vendosur në dispozicion nga Bashkia, dhe mobilimi nga UNDP/ADC.
- Hapur thirrja për aplikime për pozicionet: Punonjës me trajnim të posaçëm pranë Qendrës Berat deri më datë 17.05.2022 (*publikuar në faqen zyrtare të DNJF*).
- Përfunduar procedura e rekrutimit të 2 (dy) punonjësve të Qendrës Berat.
- Përfunduar trajnimi i detyrueshëm i punonjësve të rekrutuar në bashkëpunim me UNDP/ADC në muajin Dhjetor 2022.

QSHNJP ELBASAN

- Lidhur Marrëveshja e Bashkëpunimit "*Për vendosjen në dispozicion të ambienteve pa kundershperblim me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan*" 1195/1 prot., datë 23.05.2022.
- Përfunduar procedura e përshtatjes së zyrës së vendosur në dispozicion nga Gjykata, dhe mobilimi nga UNDP/ADC.
- Hapur thirrja për aplikime për pozicionet: Punonjës me trajnim të posaçëm pranë Qendrës Elbasan deri më datë 17.05.2022 (*publikuar në faqen zyrtare të DNJF*).
- Përfunduar procedura e rekrutimit të 2 (dy) punonjësve të Qendrës Elbasan.
- Përfunduar trajnimi i detyrueshëm i punonjësve të rekrutuar në bashkëpunim me UNDP/ADC në muajin Dhjetor 2022.

QSHNJP KUKËS

- Lidhur Marrëveshja e Bashkëpunimit "*Për vendosjen në dispozicion të ambienteve pa kundershperblim me Bashkinë Kukës*" 821/1 prot., datë 23.03.2022.
- Përfunduar procedura e përshtatjes së zyrës së vendosur në dispozicion nga Bashkia, dhe mobilimi nga UNDP/ADC.
- Hapur thirrja për aplikime për pozicionet: Punonjës me trajnim të posaçëm pranë Qendrës Kukës deri më datë 14.11.2022.
- Përfunduar procedura e rekrutimit të 2 (dy) punonjësve të Qendrës Kukës
- Përfunduar trajnimi i detyrueshëm i punonjësve të rekrutuar në bashkëpunim me UNDP/ADC në muajin Dhjetor 2022.

QSHNJP KORÇË

- Lidhur Marrëveshja e Bashkëpunimit "*Për vendosjen në dispozicion të ambienteve pa kundershperblim me Bashkinë Korce*" 820/1 prot., datë 23.03.2022.
- Hapur thirrja për aplikime për pozicionet: Punonjës me trajnim të posaçëm pranë Qendrës Korce deri më datë 14.11.2022 (*publikuar në faqen zyrtare të AKPA*).
- Përfunduar procedura e rekrutimit të 2 (dy) punonjësve të Qendrës Korçë.
- Përfunduar trajnimi i detyrueshëm i punonjësve të rekrutuar në bashkëpunim me UNDP/ADPA në muajin Dhjetor 2022.

2.1.3 Zhvendosja e Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Fier dhe Gjirokastër pas mbylljes së sporteleve ADISA (ambiente në të cilat qendrat ushtronin veprimtarinë)

Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas me shkresën me nr. 27 prot., datë 21.04.2022, është vënë në dijeni mbi urdhrin për mos ofrimin e shërbimeve fizikisht për qytetarët pranë Qendrave të Integruara Adisa. Urdhri për mbylljen e ADISA fizikisht për qytetarët preku edhe sportelet e institucioneve të tjera të vendosura në Qendrat e Integruara ADISA.

Në vijim të kësaj problematike, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, me shkresat me nr. 1104 prot., dhe 1105 prot., dt. 09.05.2022, i është drejtuar Bashkisë dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe Gjirokastër në drejtim të gjetjes së ambienteve pa kundërshtim. Në drejtim të përshpjetimit të procesit të zhvendosjes, përfaqësuesit e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas kanë zhvilluar vizita në insitucionet vendore në qytetin e Gjirokastrës dhe Fierit.

U mundësua lidhja e Marrëveshjes së Bashkëpunimit me **Këshillin e Qarkut Fier** me nr. 1104/6 prot., datë 08.06.2022. Gjithashtu, u mundësua lidhja e Marrëveshjes së Bashkëpunimit me **Bashkinë Gjirokastër** me nr 1105/7 prot., datë 09.06.2022, "Për vendosjen në dispozicion të një ambienti pa kundërshtim në godinën e Pallatit të Sportit Gjirokastër (godinë nën administrimin e Bashkisë Gjirokastër). Qendra Fier ushtron funksionin pranë Këshillit të Qarkut Fier që prej muajit Shtator 2022, ndërsa Qendra Gjirokastër ushtron funksionin pranë Pallatit të Sportit Gjirokastër që prej muajit Korrik 2022.

2.1.4 Objektivi, hapja e 6 qendrave të reja me mbështetjen e buxhetit të shtetit për gjashtë mujorin e parë të vitit 2023.

Harta e re gjyqësore (Këshilli miratoi raportin vlerësues përfundimtar të Grupit Ndërinstitucional të Punës mbi riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave) parashikon 12 gjykata të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, dhe vetëm 1 gjykatë apeli për juridiksionin e përgjithshëm dhe 1 për atë administrativ. Mbyllja e gjykatave në rrethe lind nevojën që qytetarët në këto rrethe të kenë paqartësi për procedurat që duhet të ndjekin si dhe institucionet ku duhet të drejtohen. Si rrjedhojë me qëllim garantimin e aksesit në drejtësi lind nevoja që në ambientet e gjykatave të cilat do të mbyllen të jetë funksionale 1 (një) qendër e shërbimit të ndihmës juridike parësore për të informuar të gjithë individët të cilët kërkojnë një informacion mbi procedurat dhe institucionet ku duhet të drejtohen për zgjidhjen e problematikës së tyre. (Planifikuar hapja e 6 Qendrave të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore në Tropojë, Mat, Pukë, Kurbin, Kavajë dhe Përmet).

Një projeksion paraprak i qendrave për vitin 2023, parashtrohet si më poshtë vijon:

Qendra	Hapur/Rivitalizuar	Vendndodhja	Mbështetës
Tiranë	Korrik 2021	Ministria e Drejtësisë	Buxhet Shteti
Durrës	Dhjetor 2020-UNDP Korrik 2022- Buxhet Shteti	Gjykata e Rr.Gj.Durrës	Buxhet Shteti
Fier	Shkurt 2021 Qershor 2023-Buxhet Shteti	Këshilli i Qarkut Fier (zhvendosur nga ADISA Fier)	UNDP/ADC
Lezhë	Dhjetor 2020	Bashkia Lezhë	UNDP/ADC
Lushnje	Shtator 2020	Bashkia Lushnje	Buxhet Shteti

Gjirokastër	Dhjetor 2020-UNDP Qershor 2023-Buxhet Shteti	Pallati i Sportit, Bashkia Gjiro- kastër (<i>zhvendosur nga ADISA Gjirokastër</i>)	UNDP/ADC
Shkodër	Shkurt 2021-UNDP Korrik 2022- Buxhet Shteti	Gjykata e Rr. Gj. Shkodër	Buxhet Shteti
Pogradec	Tetor 2020	Bashkia Pogradec	UNDP/ADC
Vlorë	Mars 2021	Bashkia Vlorë	UNDP/ADC
Dibër	Shkurt 2021	Gjykata e Rr. Gj. Dibër	UNDP/ADC
Elbasan	Korrik 2022	Gjykata e Rr. Gj. Elbasan	UNDP/ADC
Berat	Korrik 2022	Bashkia Berat	UNDP/ADC
Kukës	Nëntor 2022	Bashkia Kukës	UNDP/ADC
Korçë	Dhjetor 2022	Drejtoria e Kujdesit Social, Bashkia Korçë	UNDP/ADC
Tropojë	Janar-Qershor 2023	Gjykata e Rr. Gj. Tropojë	Buxhet Shteti
Kavajë	Janar-Qershor 2023	Gjykata e Rr. Gj. Kavajë	Buxhet Shteti
Kurbin	Janar-Qershor 2023	Gjykata e Rr. Gj. Kurbin	Buxhet Shteti
Përmet	Janar-Qershor 2023	Gjykata e Rr. Gj. Krujë	Buxhet Shteti
Mat	Janar-Qershor 2023	Gjykata e Rr. Gj. Mat	Buxhet Shteti
Pukë	Janar-Qershor 2023	Gjykata e Rr. Gj. Pukë	Buxhet Shteti

Me hapjen e këtyre 6 (gjashtë) qendrave të reja do të mundësohet mbulimi me 20 (njëzet) Qendra të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore

2.2 Lidhja e marrëveshjeve të bashkëpunimit me Klinikat e Ligjit pranë Institucioneve të Arsimit të Lartë me qëllim ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore

Bazuar në nenin 3 dhe 8 të ligjit 111/2017, *"Klinikë ligjore"* është njësi përbërëse e një institucioni të arsimit të lartë, e organizuar dhe që funksionon sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë dhe që ofron ndihmë juridike parësore pa qëllim fitimi, sipas përcaktimeve në statutin e institucionit të arsimit të lartë, pas lidhjes së marrëveshjes së bashkëpunimit me Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas.

Aktualisht DNJF ka lidhur marrëveshje me 12 Institucione të Arsimit të Lartë dhe konkretisht:

1. Marrëveshje Bashkëpunimi me *"Universitetin Marin Barleti"*;
2. Marrëveshje Bashkëpunimi me *"Fakultetin e Drejtësisë"*;

3. Marrëveshje Bashkëpunimi me Kolegjin Universitar "Bedër";
4. Marrëveshje Bashkëpunimi me Kolegjin Universitar "Wisdom";
5. Marrëveshje Bashkëpunimi me "Universitetin Europian të Tiranës";
6. Marrëveshje Bashkëpunimi me Universitetin "Aleksandër Moisiu Durrës";
7. Marrëveshje Bashkëpunimi me Universitetin "Ismail Qemali Vlorë";
8. Marrëveshje Bashkëpunimi me Kolegjin Universitar "Qiriazi";
9. Marrëveshje Bashkëpunimi me Fondacionin OSFA (Klinika e Ligjit Shkodër);
10. Marrëveshje Bashkëpunimi me "Universitetin Mesdhetar".
11. Marrëveshje Bashkëpunimi me "Universitetin Luarasi".

Përgjatë vitit 2022, është bërë e mundur lidhja e 1 (një) marrëveshje të bashkëpunimit si vijon:

- Marrëveshja e Bashkëpunimit me nr. 30 prot., datë 04.02.2022, me Universitetin "Epoka".

2.2.1 Angazhimi i Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas në kuadër të zhvillimit të trajnimeve për studentët

Është detyrim ligjor i Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas të bashkëpunojë me klinikat ligjore për trajnimin dhe përditësimin e njohurive të studentëve të përfshirë pranë këtyre klinikave, mbi çështjet e lidhura me ndihmën juridike parësore.

Për vitin 2022, janë trajnuar nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas 200 studentë të angazhuar pranë 12 Klinikave të Ligjit në Fakultetet e Drejtësisë (Prill-Maj 2022)

Referuar urdhrin nr. 13 datë 28.01.2022, "Për ngritjen e grupit të punës për zhvillimin e trajnimeve për studentet e angazhuar pranë Klinikave të Ligjit me të cilët DNJF ka marrëveshje bashkëpunimi", të Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas zhvilloi trajnimet me temë "Aksesi në Drejtësi dhe risitë e ligjit Nr.111/2017, "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti", me studentët e 12 (dymbëdhjetë) Klinikave të Ligjit pranë IAL-ve me të cilat Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi.

Në këtë trajnim, studentët e angazhuar pranë Klinikave të Ligjit, u informuan mbi ofruesit e ndihmës juridike, kushtet për përfitim të ndihmës juridike falas, kategoritë përfituese si dhe procedurën e dhënies së ndihmës juridike falas referuar moduleve të poshtëshënuara:

- Moduli nr. 1 "Ndhma juridike parësore";
- Moduli nr. 2 "Ndhma juridike dytësore";
- Moduli nr. 3 "Legjislacioni specifik për kategoritë e veçanta drejtëpërdrejtë përfituese të ligjit si dhe kategoritë me të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme";
- Moduli nr. 4 "Mbrojtja e të drejtave të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane".

Gjithashu u trajtuan raste praktike të lidhura ngushtësisht me problemet konkrete të institucioneve të administratës, kërkesat për informacion dhe ankesat, arrijtjet e sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti dhe sfidat për të ardhmen si dhe studentët u pajisën dhe me vërtetimet përkatëse.

2.2.2 Zhvillimi i praktikave 2 mujore të punës pranë Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas dhe Qendrave të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore në Tiranë, Durrës dhe Shkodër.

Për vitin 2022, kanë zhvilluar praktikat e punës 27 studentë në institucionin e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas dhe Qendrën e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Tiranë dhe 9 studentë në Qendrën e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Vlorë; Durrës dhe Shkodër.

Në total shprehën interesin 27 studentë të Universitetit "Marin Barleti"; Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës; Kolegjit Universitar "Bedër"; Kolegjit Universitar "Wisdom"; Universitetit Europian të Tiranës; Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës; Universitetit Ismail Qemali Vlorë; Kolegjit Universitar Qiriazi; Klinikës së Ligjit Shkodër; Universitetit "Mesdhetar"; Universitetit "Luarasi" dhe Universitetit "Epoka", të cilët sipas një grafiku të mirëpërcaktuar patën mundësinë të angazhohen në veprimtarinë e përditshme të Qendrave dhe Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas nën mbikëqyrjen e vazhdueshme të një mentori, pjesë e stafit të Drejtorisë dhe Qendrave.

2.3 Autorizimi i Organizatave Jofitimprurëse të autorizuara nga Ministri i Drejtësisë.

Bazuar në nenin 15 të ligjit 111/2017, Organizatat jofitimprurëse japin shërbime të ndihmës juridike parësore në përputhje me autorizimin e miratuar nga Ministri i Drejtësisë.

Procedurat dhe dokumentacioni për autorizimin e tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Organizatat jofitimprurëse që autorizohen për dhënien e shërbimeve të ndihmës juridike parësore duhet të përmbushin këto kritere:

- a) të jenë të regjistruara në përputhje me legjislacionin në fuqi për organizatat jofitimprurëse;
- b) të kenë si objekt të veprimtarisë së tyre të parashikuar në statutin e organizatës ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike;
- c) të kenë shlyer detyrimet tatimore në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- ç) të kenë përvojë në ofrimin e ndihmës juridike;
- d) të mos jenë në proces falimentimi dhe/ose likuidimi;
- dh) anëtarët e organit më të lartë vendimmarrës dhe të organit ekzekutiv të organizatës jofitimprurëse të mos jenë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale me dashje dhe që do të cenonte besimin e publikut dhe ofrimin e përshtatshëm të ndihmës juridike.

Procedura e parë e autorizimit të organizatave ka përfunduar në shtator të vitit 2020, ku janë autorizuar 12 (dymbëdhjetë) organizata jofitimprurëse në ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore.

Në kushtet kur afati i autorizimit është një afat 2 (dy) vjeçar, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas në bazë të ligjit nr. 111/2017, "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti" dhe VKM-së Nr. 55, datë 6.2.2019, "Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit për autorizimin e organizatave jofitimprurëse, që ofrojnë ndihmë juridike parësore të garantuar nga shteti", me shkresën me nr. 1300 prot., datë 06.06.2022, i është drejtuar Qendrës së Botimeve Zyrtare me qëllim shpalljen e thirrjes për autorizimin e organizatave jofitimprurëse në ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore për periudhën 2022-2024. Thirrja u shpall në faqen zyrtare të QBZ si dhe në faqen zyrtare të DNJF më datë 07.06.2022, dhe mbeti e hapur deri më datë 17.07.2022 .

Me qëllim kryerjen e një njoftimi sa më gjithëpërfshirës dhe transparent, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas me shkresën me nr. 1129 prot., datë 12.05.2022, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (institucioni përgjegjës për administrimin e regjistrimit të organizatave jofitimprurëse në Republikën e Shqipërisë) me qëllim vendosjen në dispozicion të listës së organizatave jofitimprurëse që kanë si pjesë të veprimtarisë së tyre ofrimin e shërbimit ligjor falas. Nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me shkresën me nr. 1129/1 prot., datë 08.06.2022, na është vendosur në dispozicion një listë e organizatave jofitimprurëse që kanë si pjesë të veprimtarisë së tyre ofrimin e shërbimit ligjor.

Organizatave jofitimprurëse (përfshirë këtu: organizatat aktualisht të autorizuar për periudhën 2020-2022; organizatat jofitimprurëse të paautorizuara me të cilat DNJF ka bashkëpunuar ngushtësisht në kuadër të projekteve të përbashkëta si dhe organizata të tjera jofitimprurëse të paautorizuara të listuara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë), janë njoftuar në rrugë shkresore mbi hapjen e thirrjes për autorizim respektivisht me shkresat me nr. 1302 prot., datë 06/06/2022; 1302/1 prot., datë 07.06.2022; 1300/1 prot., datë 07.06.2022. Gjithashtu, në kushtet kur procesi i autorizimit të OJF-ve është një proces reaktivisht i ri, me qëllim evitimin e çdo paqartësie në kuadër të procesit të aplikimit, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas më datë 13.06.2022, zhvilloi një takim online me organizatat jofitimprurëse të interesuara, me qëllim shpjegimin hap pas hapi të mënyrës dhe procesit të aplikimit.

Nga dokumentacioni i administruar në Sektorin e Arkiv-Protokollit në Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas rezulton se janë përcjell në total 19 (nëntëmbëdhjetë) aplikime nga organizatat jofitimprurëse.

Për vitin 2022, janë autorizuar 15 (pesëmbëdhjetë) organizata jofitimprurëse, 3 (tre) me shumë se në procedurën e autorizimeve për vitin 2020, me shtrirje në Tiranë, Durrës, Shkodër, Vlorë dhe Berat.

Konkretisht, lista e organizatave jofitimprurëse është si vijon:

Nr.	Emërtimi i OJF-së	Nr. Data e vendimit të MD për dhënien e autorizimit	Selia
1	<i>Forumi i Gruas Elbasan (FGE)</i> Organizatë e autorizuar, aplikon për rinovim autorizimi. Dr. Ekzekutiv: Shpresa Banja.	<i>Urdhër nr. 500 datë 27.09.2022 i Ministrit të Drejtësisë</i>	<i>Elbasan</i>
2	<i>Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri (CRCA)</i> Organizatë e autorizuar, aplikon për rinovim autorizimi. Dr. Ekzekutiv: Altin Hazizaj.	<i>Urdhër nr. 499 datë 27.09.2022 i Ministrit të Drejtësisë</i>	<i>Tiranë</i>
3	<i>Qendra për Nisma Ligjore Qytetare (QNL)</i> Organizatë e autorizuar, aplikon për rinovim autorizimi. Dr. Ekzekutiv: Aurela Bozo.	<i>Urdhër nr. 505 datë 27.09.2022 i Ministrit të Drejtësisë</i>	<i>Tiranë</i>
4	<i>Qendra Psiko-Sociale Vatra</i> Organizatë që aplikon për herë të parë. Dr. Ekzekutiv: Brikena Puka.	<i>Urdhër nr. 512 datë 27.09.2022 i Ministrit të Drejtësisë</i>	<i>Vlorë</i>
5	<i>Qendra e Gruas Hapa të Lehtë</i> Organizatë që aplikon për herë të parë. Dr. Ekzekutiv: Denada Shpuza.	<i>Urdhër nr. 503 datë 27.09.2022 i Ministrit të Drejtësisë</i>	<i>Shkodër</i>

6	Qendra ALTRI Organizatë e autorizuar, aplikon për rinovim autorizimi. Dr. Ekzekutiv: Eda Noçka.	Urdhër nr. 498 datë 27.09.2022 i Ministrit të Drejtësisë	Tiranë
7	Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza Organizatë e autorizuar, aplikon për rinovim autorizimi. Dr. Ekzekutiv: Iris Luarasi.	Urdhër nr. 501 datë 27.09.2022 i Ministrit të Drejtësisë	Tiranë
8	Shoqata "Mbrotjtja e të Drejtave të Gruas Fshatare dhe Qytetare Berat" Organizatë e autorizuar, aplikon për rinovim autorizimi. Dr. Ekzekutiv: Artë Dyrmishi.	Urdhër nr. 509 datë 27.09.2022 i Ministrit të Drejtësisë	Berat
9	Shoqata "Shërbimet shqiptare për refugjatët dhe migrantët" Organizatë e autorizuar, aplikon për rinovim autorizimi. Dr. Ekzekutiv: Marjana Hereni	Urdhër nr. 508 datë 27.09.2022 i Ministrit të Drejtësisë	Tiranë
10	Organizata "Refleksione" Organizatë që aplikon për herë të parë. Dr. Ekzekutiv: Anthulla Ruçi.	Urdhër nr. 507 datë 27.09.2022 i Ministrit të Drejtësisë	Tiranë
11	Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin Organizatë që aplikon për herë të parë. Dr. Ekzekutiv: Elona Hoxha.	Urdhër nr. 504 datë 27.09.2022 i Ministrit të Drejtësisë	Tiranë
12	Qendra "Konsumatori Shqiptar" Organizatë e autorizuar, aplikon për rinovim autorizimi. Dr. Ekzekutiv: Ersida Teliti	Urdhër nr. 501 datë 27.09.2022 i Ministrit të Drejtësisë	Durrës
13	Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara Organizatë e autorizuar, aplikon për rinovim autorizimi. Dr. Ekzekutiv: Anjeza Puka	Urdhër nr. 506 datë 27.09.2022 i Ministrit të Drejtësisë	Tiranë
14	Organizata "Të ndryshëm dhe të barabartë" Organizatë e autorizuar, aplikon për rinovim autorizimi. Dr. Ekzekutiv: Marjana Meshi	Urdhër nr. 510 datë 27.09.2022 i Ministrit të Drejtësisë	Tiranë
15	Organizata "Shërbimi ligjor falas Tiranë" Organizatë e autorizuar, aplikon për rinovim autorizimi. Dr. Ekzekutiv: Rajmonda Bozo	Urdhër nr. 511 datë 27.09.2022 i Ministrit të Drejtësisë	Tiranë




2.4 Të dhënat statistikore për vitin 2022, ndihma juridike parësore

41 ofrues të shërbimit të ndihmës juridike të cilët gjejnë shtrirje në 100 % të territorit të vendit

- ✓ **14 (katërbëdhjetë)** qendra të shërbimit të ndihmës juridike parësore në Tiranë; Durrës; Shkodër; Lezhë; Lushnje; Pogradec; Gjirokastër; Vlorë; Fier; Dibër; Kukës; Korçë; Berat dhe Elbasan;
- ✓ **15 (pesëmbëdhjetë) organizata** jofitimprurëse të cilat operojnë në Tiranë; Durrës; Elbasan; Berat; Shkodër dhe Vlorë të autorizuara nga Ministri i Drejtësisë
- ✓ **12 (dymbëdhjetë Marrëveshje Bashkëpunimi me Klinikat Ligjore** pranë IAL-ve që operojnë në Tiranë; Vlorë dhe Shkodër.
- ✓ Ndhma Juridike Parësore ONLINE (platformajuristionline.al)
- ✓ Numri i gjelbër pa pagesë 08001010

Muaji	Qendrat e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore	Organizatata jofitimprurëse të autorizuara	Klinikat e Ligjit pranë IAL	Platforma juristionline	Numri i gjelbër	Total
Janar	296	224	0	123	24	667
Shkurt	276	236	0	126	20	658
Mars	251	221	0	127	20	619
Prill	259	197	0	151	15	622
Maj	258	235	0	126	22	641
Qershor	255	214	0	114	55	638
Korrik	218	155	0	96	17	486
Gusht	164	163	0	87	36	450
Shtator	286	252	0	106	24	668
Tetor	302	314	0	115	49	780
Nentor	278	285	0	131	33	727
Dhjetor	230	292	0	116	22	660
Total	3073	2788	0	1418	337	7616

TOTAL NDIHMA JURIDIKE PARËSORE: 7616 RASTE TË RAPORTUARA





Lloji i ndihmës	Romë / Egjiptian	Viktima Dhune	Viktima trafikimi	PAK	Të mitur
<i>Ndihmë Juridike Parësore</i>	304	819	80	326	317

Shënim:

- ❖ Sa i përket ndihmës juridike parësore: Theksojmë se në **numrin e viktimave të dhunës, romëve dhe egjiptianëve, si dhe viktimave të trafikimit, viktimave të mundshme të trafikimit, nuk janë përfshirë rastet e trajtuara në platformën juristonline.al dhe numrit të gjelbër 08001010.** (Shërbimi në këto platforma ofrohet për të gjithë qytetarët, pa u bërë kategorizimi i tyre). **4756 raste pa u përfshirë platforma juristonline dhe numri i gjelber.**

- ❖ Sa i përket ndihmës juridike parësore: Theksojmë se në **numrin e qytetarëve përfitues sipas gjinisë nuk janë përfshirë rastet e trajtuara në platformën juristionline.al dhe numrit të gjelbër 08001010.** (Shërbimi në këto platforma ofrohet për të gjithë qytetarët, pa u bërë kategorizimi i tyre). **4756 raste pa u përfshirë platforma jurisionline dhe numri i gjelber.**
- ❖ Sa i përket ndihmës juridike parësore: Sa i përket **kategorisë romë dhe egjiptiane**, kjo është një **e dhënë që na përcillet vullnetarisht nga ana e ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike parësore** në kushtet kur kjo kategori nuk është përfshirë në mënyrë eksplicite në ligj si kategori përfituese.



**TOTAL NDIHMJA JURIDIKE PARËSORE
2018-2022 (19.983 Raste)**

3. Ndihma juridike dytësore

Ndihma juridike dytësore është një nga format më thelbësore të shërbimit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti në kuadër të garantimit të aksesit të barabartë në drejtësi. Me ndryshimet e reja të kuadrit ligjor për ndihmën juridike, përveç përfaqësimit me avokat falas, tashmë qytetarët në nevojë dhe kategoritë vulnerabël kanë mundësi të përfitojnë edhe nga forma e shtuar të shërbimit ligjor falas, atë të përjashtimit nga të gjitha tarifat dhe shpenzimet gjyqësore.

Nisur dhe nga natyra e çështjeve të ndihmës juridike, karakteri sensitiv që ato kanë, përfaqësimi me avokat falas dhe ndjekja e procesit në gjykatë është i një rëndësie thelbësore për rivendosjen në vend të të drejtave për kërkuesit e shërbimit.

Ndihma juridike dytësore jepet nga avokatët që përfshihen në listën e miratuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë, në bazë të kërkesës së personit që gëzon të drejtën për përfitimin e ndihmës juridike dytësore, sipas neneve 11 ose 12, Ligjit Nr.111/2017.

3.1 Procesi i lidhjes së kontratave me avokatët

Në zbatim të kompetencave të përcaktuara në nenin 8 të Ligjit Nr. 111/2017, gërma k), DNJF lidh, deri më 1 mars të çdo viti kalendarik, kontratat e përvitshme të shërbimit me avokatët e përfshirë në listën e miratuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë për ofrimin e ndihmës juridike dytësore.

Në muajin Janar, u zhvillua procedura e hedhjes së shortit për përgatitjen e listës dhe caktimin e avokatëve që do të ofrojnë ndihmë juridike dytësore në proceset civile dhe administrative për vitin 2022.

Gjatë kësaj procedure u respektua Parimi i Rotacionit si dhe të gjitha rregullat e parashikuara në Udhëzimin e Përbashkët Nr.17, datë 05.08.2020, të Ministrisë së Drejtësisë dhe Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë, duke garantuar kështu një proces transparent dhe gjithëpërfshirës.

Pas miratimit të listës së avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore nga DHASH, DNJF vijoi me procesin e lidhjes së kontratave me avokatët e miratuar nga Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë për vitin 2022.

Janë lidhur kontratat me avokatët për ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike dhe Lista e Avokatëve është publikuar në faqen zyrtare të DNJF. Nga **161 avokatë** që lidhën kontratë për ofrimin e shërbimit për ndihmën juridike dytësore, **katër** avokatë u tërhoqën në mënyrë të njëanshme për shkaqe ligjore. *Lista i është komunikuar Dhomës Kombëtare të Avokatisë dhe Ministrisë së Drejtësisë me shkresën Nr. 739/1, datë 05.04.2022.*Në vijim, gjatë vitit 2022 kanë ofruar shërbimin e ndihmës juridike dytësore **157 avokatë**.

3.2 Trajnimi i avokatëve pjesë e listës

Me qëllim asistimin e avokatëve në procesin e dhënies së ndihmës juridike dytësore, raportimit për sa i përket ndjekjes së çështjeve; ndërveprimet të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas me Dhomat Vendore të Avokatisë si dhe të shkëmbimit të konsideratave janë zhvilluar trajnime dedikuar për ndihmën juridike dytësore.

Referuar nenit 9 pika "d" të ligjit nr. 111/2017 "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti" parashikon se: Dhoma Kombëtare e Avokatisë, përgatit dhe organizon programet e trajnimit të vazhdueshëm për avokatët e përfshirë në listën e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore, në bashkëpunim me Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas.

Në zbatim të detyrave ligjore DHKA në bashkëpunim me DNJF kanë organizuar trajnimet e mëposhtme.

- Më datë **26-27 Maj 2022 dhe më datë 13 -14 Shtator 2022** janë zhvilluar trajnimet për avokatët e përfshirë në listën e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore në DHVA Tiranë.
- Më datë **20-21 Tetor 2022** janë zhvilluar trajnimet për avokatët e përfshirë në listën e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore në DHVA Pogradec.
- Më datë **21-22 Dhjetor 2022** janë zhvilluar trajnimet për avokatët e përfshirë në listën e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore në DHVA Vlorë.

Gjatë trajnimeve, ofruesve të ndihmës juridike dytësore ju është vënë theksi specifikisht si më poshtë:

- Legjislacioni mbi ndihmën juridike dhe rëndësia e tij edhe në nivel ndërkombëtar;
- Ligji për ndihmën juridike dhe aktet nënligjore të miratuara në zbatim të tij;
- Format e shërbimit të ndihmës juridike dhe subjektet përfitues të shërbimit;
- Analizë në aspektin praktik;
- Standardet e ofrimit të shërbimit në përputhje me jurisprudencën e GJEDNJ-së;
- Diskutime praktike ndërmjet ofruesve të shërbimit, Dhomave të Avokatisë dhe Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas.

Pas diskutimeve të temave mbi kuadrin ligjor të përgjithshëm mbi ndihmën juridike, aspektet e dala nga zbatimi në praktikë i ligjit, trajnimet ju dedikuan dhe temave të posaçme të lidhura me kategoritë e veçanta përfituese të ligjit.

3.3 Ecuria e vendime për pranimin e ndihmës dytësore


Nga vendimet gjyqësore me objekt kërkesën për ndihmë juridike dytësore falas, të administruara nga DNJF për Vitin 2022, në total rezultojnë **1030** vendime gjyqësore. Këto vendime mbi kërkesat për ndihmë juridike dytësore të detajuara në formë tabelare janë si vijon:

Vendime Gjyqësore me Objekt Kërkesën për Ndhimë Juridike Dytësore


JANAR - DHJETOR 2022

Pranim të kërkesës për ndihmë juridike dytësore	Rrëzim të kërkesës për ndihmë juridike dytësore	Pranim të kërkesës për përjashtim nga taksat dhe shpenzimet gjyqësore	Rrëzim të kërkesës për përjashtim nga taksat dhe shpenzimet gjyqësore	Pranim të kërkesës për ndihmë juridike dytësore dhe kërkesës për përjashtim nga taksat dhe shpenzimet gjyqësore	Rrëzim të kërkesës për ndihmë juridike dytësore dhe kërkesës për përjashtim nga taksat dhe shpenzimet gjyqësore	Kthim aktesh/ pushim çështjeje/ çështjeje në gjykim/ moskompetencë/
126	6	264	5	592	25	12

Totali i Vendimeve Gjyqësore për Kërkesat për Ndhimë Juridike Dytësore = 1030



Në ecurinë përgjatë muajve, mesatarja aritmetike e kërkesave të pranura për ndihmë dytësore juridike është përafërsisht **85** kërkesa për muaj. Muaji me numrin më lartë të kërkesave të pranura ishte muaji **Maj** me **185** vendime dhe numri me numrin më të ulët të kërkesave të pranura ishte muaji **Gusht** me **19** vendime.



KËRKUESIT E NDIHMËS JURIDIKE DYTËSORE SIPAS VENDIME GJYQËSORE PËR VITIN 2022


■	Pamundësi financiare	28%
■	Kategori të veçanta	61%
■	Kategori e papërcaktuar	11%



GJINIA E KËRKUESVE TË NDIHMËS SIPAS VENDIME GJYQËSORE PËR VITIN 2022

■	Gra	65%
■	Burra	35%

VENDIMET E GJYKATAVE PËR KËRKESAT PËR NDIHMË JURIDIKE TË GARANTUAR SIPAS OBJKTIT PËR VITIN 2022



Përsa i përket kategorive të personave kërkues të ndihmës juridike dytësore falas, në total evidentohet se **28%** e përfituesve janë në pamundësi financiare, si mungesë të ardhurash dhe pasurie, në **61%** përfshihen kategoritë e veçanta ligjore si personat viktimë të dhunës, përfitues të skemave sociale e të tjerë, ndërsa **11%** e tyre janë kategori e papërcaktuar. Përsa i përket gjinisë, **65%** e kërkuesve rezultojnë gra dhe **35%** rezultojnë burra.


Sipas objektit të çështjeve gjyqësore që qytetarët kanë kërkuar ndihmë juridike dytësore, evidentohet që kryesisht që janë çështje të karakterit civil. Nga totali i kërkesave për ndihmë juridike prej **1030**, prej tyre **691** janë civile, ku më kryesoret janë zgjidhje martesë, përfitim pensioni dhe konflikte pronësie. Ndërsa dy kategoritë e tjera, ku **70** janë penale dhe **269** janë çështje administrative.

Përsa i përket pranimit të kërkesave të qytetarëve nga vendimet e gjykatave, evidentohet një marzh shumë i ulët i refuzimit. Nga totali i kërkesave, në **48** vendime gjykatat janë shprehur për refuzim të kërkesës për ndihmë juridike dytësore falas, thënë ndryshe në **7%** të totalit.

Referuar detyrimeve dhe tagrave ligjore, Drejtoria Ndihmës juridike Falas **përsa i përket vendimeve për pranim të dhëna nga gjykatat, ka kryer ankime dhe ankesa për ndreqje gabimesh**. Përsa i përket ankimeve, DNJF ka ankimuar ose ka bërë kërkesë për ndreqje gabimi për rreth 7% të totalit. Një pjesë e konsiderueshme e këtyre kërkesave kanë ardhur për mangësi formale në vendimmarrjen e gjykatave, por gjithashtu një pjesë të konsiderueshme zënë raste ku DNJF ka pretenduar një vendimmarrje jo të saktë nga gjykatat. Konkretisht, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas ka ushtruar të drejtën e ankimit për 43 raste, nga të cilat 2 kërkesa ankimore janë pranuar (1 nga Gjykata e Apelit Vlorë dhe 1 nga Gjykata e Apelit Shkodër), ndërsa 17 kërkesa ankimore nuk janë pranuar (6 nga Gjykata e Apelit Vlorë, 4 nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, 4 nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, 1 nga Gjykata e Apelit Durrës, 1 Gjykata e Apelit Shkodër dhe 1 Gjykata Administrative e Apelit Tiranë) dhe për 24 kërkesa ankimore nuk është dhënë ende një vendim nga gjykata. Në lidhje me kërkesat për ndreqje të gabimit, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas ka paraqitur 32 kërkesa, ndër të cilat rezulton se 14 kërkesa për ndreqje gabimi janë pranuar (5 nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, 2 nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, 2 nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet, 2 nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, 1 nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, 1 nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër dhe 1 nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës), 3 kërkesa për ndreqje gabimi janë rrëzuar (1 nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, 1 nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat dhe 1 nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë), për 2 kërkesa për ndreqje gabimi është vendosur pushim nga gjykata (1 nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe 1 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat) dhe për 13 kërkesa për ndreqje gabimi nuk është dhënë ende një vendim nga gjykata.

Përsa i përket llojit të ndihmës juridike dytësore falas të kërkuar, nga **1030** vendime në total, **132** prej tyre janë për kërkesa për të përfituar avokat, **269** për të përfituar mbulim të shpenzimeve gjyqësore dhe **617** janë kërkesa për të përfituar avokat dhe mbulim të shpenzimeve gjyqësore, nga të cilat janë rrëzuar **36** kërkesa dhe **12** janë kthim aktesh/pushim çështje.

RAPORTI I NATYËS SË NDIHMËS JURIDIKE TË KËRKUAR NË VITET 2019, 2020, 2021 DHE 2022



3.4 Caktimi i Avokatëve

Nëse analizojmë tërë vendimmarrjen e gjykatave, të përshkruar më sipër, konkretisht, rezulton se Dhomat Vendore të Avokatisë do të duhej të kishin komunikuar vendimmarrjen për caktim të **718 avokatëve**. Ky numër rezulton nga shumatorja e kërkesave për të përfituar avokat, dhe kërkesave për të përfituar avokat dhe mbulim të shpenzimeve gjyqësore. Prej këtij totali, zbritet numri i vendimeve të marra për refuzim të kërkesës nga gjykatat¹.

Nga analiza e të dhënave rezulton se, Dhoma Vendore e Avokatisë Durrës ka përcjellë numrin më të lartë të vendimeve për caktimin e avokatëve për **79** raste. Ajo ndiqet nga Dhoma Vendore Vlorë për **32** raste, dhe Dhoma Vendore Gjirokastrë dhe Berat nga **30** raste. Në total rezulton se nga Dhomat Vendore janë përcjellë **199** vendime për caktim avokatësh, të cilat i janë komunikuar DNJF përgjatë vitit 2022.

1 Nga ky numër duhet të zbritet, në rastin nëse gjykatat do të pranojnë ankimet e depozituara nga DNJF.

Përcjellja e vendimeve për caktim avokati për vitin 2022		
	Dhomat Vendore të Avokatisë	Nr. i vendimeve
1	Dhoma vendore e Avokatisë Durrës	79
2	Dhoma vendore e Avokatisë Berat	30
3	Dhoma vendore e Avokatisë Lezhë	8
4	Dhoma vendore e Avokatisë Gjirokastrë	30
5	Dhoma vendore e Avokatisë Shkodër	20
6	Dhoma vendore e Avokatisë Vlorë	30

Sipas këtyre shifrave, rezulton se për rreth **2/3 të vendimeve gjyqësore** që kanë pranuar kërkesën e qytetarëve për avokatë, Dhomat Vendore të Avokatisë nuk kanë komunikuar vendimin e caktimit të avokatit. Në këto rrethana, ndër të tjera, bëhet e pamundur vlerësimi nëse Dhomat kanë respektuar parimin e rotacionit në vendimmarrjen e tyre.

3.5 Një konkluzion i të dhënave statistikore me një qasje krahasuese:

- I. Nga analiza e të dhënave, në krahasim me ecurinë gjatë vitit 2019, 2020 dhe 2021 konstatohet një rritje progresive me shumëfishim të kërkesave për ndihmë juridike dytësore dhe përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore. Më konkretisht, për vitin 2019, janë marrë **32** vendime nga gjykatat mbi kërkesa për ndihmë juridike, në vitin 2020, janë marrë **181** vendime nga gjykatat mbi kërkesa për ndihmë juridike, për vitin 2021 janë **849** vendime nga gjykatat mbi kërkesa për ndihmë juridike të garantuar nga shteti, ndërsa për vitin 2022 janë **1030** vendime nga gjykatat mbi kërkesa për ndihmë juridike të garantuar nga shteti
- II. Përsa i përket raportit të natyrës së çështjeve gjyqësore për të cilat është kërkuar ndihmë, në analizë disa vjeçare shihet ruajtja e plotë e raportit. Më konkretisht çështjet civile shkojnë deri më 90% të totalit të çështjeve për të cilat kërkohet ndihmë. Më konkretisht, në vitin 2019, nga **32** vendime, **28** ishin për çështje civile, **4** penale dhe **1** administrative. Në vitin 2020, nga **181** vendime, **154** ishin për çështje civile, **13** penale dhe **14** administrative, për vitin 2021 nga **849** vendime, **754** ishin për çështje civile, **61** penale dhe **57** administrative, ndërsa për vitin 2022 nga **1030** vendime, **691** ishin për çështje civile, **70** penale dhe **269** administrative
- III. Përsa i përket natyrës së ndihmës dytësore falas të kërkuar nga qytetarët, në raportin ndër vite shihet një raport kostant. Në rreth **25%** të totalit të kërkesave kërkohet vetëm mbulim i shpenzimeve gjyqësore. Ndërsa në pjesën tjetër kërkohet avokat, sëbashku ose jo edhe mbulim të shpenzimeve gjyqësore.

3.6 Problematika lidhur me ndihmën juridike dytësore:

- Disa vendime të gjykatave vijnë pa firmë dhe vulë sipas parashikimeve në K.Pr. Civile, përmendim këtu Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë;
- Vendimet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Tiranës dhe rretheve vijnë deri më 6 muaj vonesë në protokollin e DNJF-së, duke sjellë pasoja për qytetarët;
- Është vënë re se avokatët kalojnë afatin 3 muaj për ngritjen e padisë në gjykatat e juridiksionit;
- Mungesa e informacionit nga momenti i ngritjes së padisë deri në çdo fazë të gjykimit, civil, penal, administrativ nga avokatët dhe dhomat e avokatisë në Tiranë dhe rrethe;
- Dhomat Vendore të Avokatisë nuk përcjellin vendimet për caktim avokati pranë DNJF-së.

TOTAL NDIHMA JURIDIKE DYTËSORE
2019-2022 (2.104 vendime gjyqësore)

4. Monitorimi i cilësisë së ofrimit të ndihmës parësore dhe dytësore

4.1 Monitorimi i cilësisë së ofrimit të ndihmës parësore (Janar-Dhjetor 2022)

Referuar Ligjit nr. 111/2017, "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti", në nenin 8 të tij, përcaktohet si një ndër detyrat e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas: Zbatimi i sistemit të vlerësimit të cilësisë së dhënies së ndihmës juridike dhe mbikëqyrja çdo vit e standardeve të ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike parësore dhe dytësore nga organizatat jofitimprurëse dhe avokatët.

Në zbatim të këtyre parashikimeve, me Urdhrin nr. 534, datë 25.11.2019, "Për miratimin e kriterëve dhe metodologjisë për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas të shërbimeve të ndihmës juridike", është miratuar metodologjia që do të ndiqet për të vlerësuar dhe mbikëqyrur cilësinë e shërbimeve të ofruara të ndihmës juridike.

Për të përmbushur qëllimet e përfunduara në ligj, Drejtoria e Mbikëqyrjes së Standardeve të Ofrimit të Shërbimit të Ndhmës Juridike është drejtoria e krijuar brenda Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas që ka përgjegjësinë e kryerjes së monitorimeve fillestare dhe të vazhdueshme në funksion të vlerësimit të cilësisë së shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe dytësore.

Krijimi i një sistemi të ndihmës juridike falas i cili siguron akses të barabaratë të të gjithë individëve në sistemin e drejtësisë; mirëorganizimi, mirëadministrimi dhe mirëfeksionimi i institucioneve shtetërore përgjegjëse për administrimin e ndihmës juridike si dhe garantimi i ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike në mënyrë profesionale, cilësore, efiçente dhe efektive janë disa nga qëllimet kryesore të Ligjit nr.111/2017 "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti".

Këto qëllime shërbejnë si udhëzues të mënyrës si kryhet monitorimi i cilësisë së shërbimit, procesi i cili detajohet në Urdhrin nr. 534, datë 25.11.2019, "Për miratimin e kritereve dhe metodologjisë për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas të shërbimeve të ndihmës juridike".

Në përmbushje të shkronjës "I" të nenit 8 të ligjit nr. 111/2017, "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti" ku përcaktohet se: "Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas mbikëqyr çdo vit standardet e ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dytësore", DNJF ka hartuar kalendarin e mbikëqyrjes për vitin 2022, në të cilin ka detajuar të gjitha monitorimet që do të kryhen përgjatë këtij viti.

Lidhur me monitorimin e avokatëve të ndihmës juridike, Drejtoria e Mbikëqyrjes së Standardeve të Ofrimit të Shërbimit të Ndihmës Juridike ka vijuar me kryerjen e monitorimeve e të gjitha Qendrave dhe monitorimin fillestar të avokatëve ofrues të shërbimit të ndihmës juridike dytësore.

4.1.1 Analizë e raporteve të monitorimit të kryera në Qendrat e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore

Referuar parashikimeve të metodologjisë së miratuar me Urdhër të Ministrit të Drejtësisë, vlerësimi i cilësisë së shërbimit të ofruar nga qendrat bazohet në monitorimet 3 (tre)-mujore të kryera si dhe raportet mujore narrative të përcjella nga ana e punonjësve të Qendrave. Për çdo raport mujor të përcjellë analizohen të dhënat si dhe orientimi ligjor/ zgjidhja e rasteve të trajtuara. Gjithashtu, raportet synojnë të adresojnë problematika dhe rekomandime nga ana e punonjësve të qendrave në funksion të përmirësimit të ecurisë së veprimtarisë dhe ofrimit të shërbimit nga ana e tyre.

Nga monitorimet e kryera në Qendrat e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore, **ka rezultuar** se:

- Lidhur me mbajtjen dhe administrimin e dokumentacionit të kërkuar sipas ligjit nr.111/2017:

Pjesa më e madhe e Qendrave administrojnë dokumentacionin që kërkohet për të përfituar nga shërbimi i ndihmës juridike parësore (formularët e aplikimit; dokumentat vërtetues për kushtet e pamundësisë / kategoritë e veçanta; skeda e klientit; procesverbali etj), por jo të gjitha Qendrat administrojnë dokumentacion për mënyrën e zgjidhjes së çështjes. (dokumentacionin provues -shkresor ose në cdo formë tjetër të kërkuar nga ligji).

- Pritja dhe trajtimi i qytetarëve, përfitues të shërbimit:

Pritja dhe trajtimi i klientëve duhet të formalizohet përmes një protokollit të mirëfilltë, sipas parashikimeve në Urdhrin e miratuar nga Ministri i Drejtësisë (ky protokoll mund të punohet duke bashkëpunuar edhe me punonjësit e Qendrave të tjera që administrohen nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas). Rezulton se pjesa më e madhe e Qendrave nuk e kanë këtë dokument.

Konkluzione:

1. Përcjellja e raporteve mujore narrative

Lidhur me përcjelljen e Raporteve Mujore Narrative nga ana e Qendrave të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore, rezulton se jo të gjitha qendrat i përcjellin për çdo muaj respektiv (*raporti është për qendrën dhe jo për punonjës*). Vihet re një mungesë bashkëpunimi në këtë kuadër.

2. Punonjësit e qendrave nuk përcjellin problematika / rekomandime

Në raportet mujore rezulton se në pjesën më të madhe të tyre nuk plotësohet rubrika në të cilën pasqyrohen problematika / vështirësi që qendrat hasin në terren dhe rekomandime nga ana e punonjësve. Plotësimi i kësaj rubrike është shumë i rëndësishëm në kuadër të bashkëpunimit efektiv dhe marrjes së masave nga ana e Drejtorisë së Ndhmës Juridike për zgjidhjen e problematikave që përcillen.

3. Numri i ulët i rasteve në disa qendra

Nga raportet e dërguara nga ana e qendrave si dhe nga të dhënat statistikore të përpunuara nga Drejtoria e Politikave sa i përket qendrave parësore, rezulton se nga disa qendra është trajtuar një numër i ulët rastesh.

Rekomandime:

- Të vijohet ofrimi i shërbimit të ndihmës juridike parësore me efikasitet të plotë duke trajtuar çdo rast sipas specifikave konkrete.
- Të vijohet me promovimin e sistemit të ndihmës juridike dhe orientimin sa i përket përfitimit të ndihmës juridike dytësore.
- **Në fokus:** rritja e numrit të rasteve që adresohen pranë qendrës.
- Rekomandohet bashkëpunimi edhe me qendrat e reja të shërbimit të ndihmës juridike parësore të administruara nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas.

4.1.2 Ecuria e kryerjes së monitorimeve të qendrave

Monitorimet u ushtruan duke pasur në fokus, mënyrën e ofrimit të ndihmës juridike parësore dhe nëse përmbushen qëllimet e përgjithshme të ofrimit të këtij shërbimi, të mirëorganizimit, mirëadministrimit, mirëfunksionimit, profesionalizmit, cilësisë, dhe efektivitetit.

- Monitorimi dhe kontaktimi i vazhdueshëm me qendrat është një proces periodik që është realizuar sipas kalendarit të monitorimeve për vitin 2022.
- Pas miratimit të Kalendarit të Monitorimeve për vitin 2022 me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm Nr. 23, datë 10.02.2022, protokolluar me 386 Prot., datë 10.02.2022 janë kryer Monitorimet për Qendrat e Ndhmës Juridike Parësore.
- Gjithashtu u planifikua dhe vijimi i monitorimeve sipas ciklit periodik për qendrat e tjera të cilat nuk mundën të realizoheshin për shkak të VKM-së Nr. 160, datë 14.03.2022, "Për reduktimin e shpenzimeve të transportit për funksionarët, nëpunësit, punonjësit e institucioneve të administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministratave dhe Shoqërive/Ndërmarrjeve me kapital shtetëror".

Në zbatim të Urdhrit nr. 531, datë 25.11.2019, "Për miratimin e kriterëve dhe metodologjinë për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas të shërbimeve të ndihmës juridike", dhe VKM-së Nr. 160, datë 14.03.2022, "Për reduktimin e shpenzimeve të transportit për funksionarët, nëpunësit, punonjësit e institucioneve të administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministratave dhe Shoqërive/Ndërmarrjeve me kapital shtetëror", referuar këtij akti nënligjor nuk mund të realizohej monitorimi i QSHNJP në mënyrë fizike nga ana e punonjësve të DNJF-së.

Gjithashtu, duke ju referuar shkresës tonë nr. 465/2 Prot., datë 18.05.2022, me lëndë "Kërkesë për miratimin e autorizimeve për lëvizjet e punonjësve jashtë qendrës së punës" deri në kthim përgjigje, nuk ka qenë e mundur realizimi i monitorimeve fillestare për të gjitha Qendrat. Në përgjigje të shkresës, komunikohet urdhëri nr. 234, datë 24.05.2022, "Për delegim kompetence", Drejtorit të Përgjithshëm të DNJF-së në autorizimin e punonjësve për kryerjen e shërbimeve brenda vendit, jashtë qendrës së punës është vijuar me monitorimet në vazhdimësi.

- Monitorimi i QSHNJP **Shkodër** realizuar sipas urdhërit nr. 3, datë 06.01.2022, "Për Mbikëqyrjen dhe Kontrollin e Cilësisë së Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Shkodër";
- Monitorimi i QSHNJP **Gjirokastrë** realizuar sipas urdhërit nr. 43, datë 23.02.2022, "Për Mbikëqyrjen dhe Kontrollin e Cilësisë së Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Berat";
- Monitorimi i QSHNJP **Vlorë** realizuar sipas urdhërit nr. 42, datë 23.02.2022, "Për Mbikëqyrjen dhe Kontrollin e Cilësisë së Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Vlorë";
- Monitorimi i QSHNJP **Durrës** realizuar sipas urdhërit nr. 56, datë 08.03.2022, "Për Mbikëqyrjen dhe Kontrollin e Cilësisë së Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Durrës";
- Monitorimi i QSHNJP **Lushnje** realizuar sipas urdhërit nr.55, dat 08.03.2022, "Për Mbikëqyrjen dhe Kontrollin e Cilësisë së Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Lushnje";
- Monitorimi i QSHNJP **Tiranë** realizuar sipas urdhërit nr. 57, dat 09.03.2022, "Për Mbikëqyrjen dhe Kontrollin e Cilësisë së Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Tiranë";
- Monitorimi i QSHNJP **Berat** realizuar sipas urdhërit nr. 1717, datë 22.06.2022, "Për Mbikëqyrjen dhe Kontrollin e Cilësisë së Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Berat";
- Monitorimi i QSHNJP **Lezhë** realizuar sipas urdhërit nr. 284, datë 15.09.2022. "Për Mbikëqyrjen dhe Kontrollin e Cilësisë së Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Lezhë";
- Monitorimi i QSHNJP **Fier** realizuar sipas urdhërit nr. 287, datë 13.09.2022. "Për Mbikëqyrjen dhe Kontrollin e Cilësisë së Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Fier";
- Monitorimi i QSHNJP **Pogradec** realizuar sipas urdhërit nr. 171, datë 22.06.2022. "Për Mbikëqyrjen dhe Kontrollin e Cilësisë së Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Pogradec";
- Monitorimi i QSHNJP **Elbasan** realizuar sipas urdhërit nr. 101, datë 02.09.2022. "Për Mbikëqyrjen dhe Kontrollin e Cilësisë së Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Elbasan";
- Monitorimi i QSHNJP **Dibër** realizuar sipas urdhërit nr. 267, datë 22.08.2022. "Për Mbikëqyrjen dhe Kontrollin e Cilësisë së Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Dibër".

Kalendari i monitorimeve të kryera për vitin 2022		
	Qendrat e Shërbimit	Kryerja e Monitorimit
1	Qendra Durrës	08.03.2022
2	Qendra Tiranë	09.03.2022
3	Qendra Lushnje	08.03.2022
4	Qendra Berat	22.06.2022
5	Qendra Lezhë	15.09.2022.
6	Qendra Pogradec	22.06.2022
7	Qendra Fier	13.09.2022
8	Qendra Elbasan	02.09.2022
9	Qendra Dibër	22.08.2022
10	Qendra Shkodër	06.01.2022
11	Qendra Vlorë	32.02.2022
12	Qendra Gjirokastër	23.02.2022

4.1.3 Konkluzione dhe Rekomandime nga Monitorimet e Qendrave të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore

Nga monitorimi i kryer pranë Qendrave të Ndhmës Juridike Parësore rezultojnë se:

- Është mbajtur numri i rasteve të trajtuara për periudhën Janar- Dhjetor 2022(raste të raportuara sipas Formateve të miratuara në Ministrinë e Drejtësisë).
- Është mbajtur skeda e klientit për ndihmën juridike parësore (Aneksi 1, detyrim ligjor që rrjedh nga Urdhër nr.531, datë 25.11.2019 të Ministrit të Drejtësisë "Për Miratim e kriterëve dhe metodologjisë për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas të shërbimeve të ndihmës).
- Janë mbajtur dhe plotësuar formularët për ndihmë juridike parësore, sikurse është përcaktuar në ligj. (nga shqyrtimi i dosjeve rezultoi se punonjësit kanë mbajtur dhe plotësuar në mënyrë të rregullt dhe administrojnë formularët e ndihmës juridike parësore sikurse parashikohet në ligj dhe aktet nënligjore).
- Është mbajtur dhe administrohet dokumentacioni provues që kërkuesit i është ofruar zgjidhja e problematikës së parashtruar. (nga shqyrtimi i dosjeve rezultoi se nga ana e punonjësve të qendrës administrohet dokumentacioni provues që kërkuesit i është ofruar zgjidhja e problematikës dhe që është subjekt përfitues nga ndihma juridike falas);
- Konstatohet se është mbajtur dhe administrohet dokumentacioni provues për subjektet që përfitojnë nga ndihma juridike.

Rekomandime:

- Të vijohet me promovimin e sistemit të ndihmës juridike dhe orientimin sa i përket përfitimit të ndihmës juridike dytësore.
- Rezultojnë se nuk ka një protokoll të formalizuar për procesin e pritjes dhe trajtimit të klientit.

- Të mbahet protokoll i mirëfilltë për pritjen dhe trajtimin e klientëve.
- Është mbajtur pjesërisht (në disa qendra) dokumentacioni provues mbi ndjekjen e problematikës së parashtruar për rastet kur është proceduar me shkresë drejtuar institucioneve shtetërore, dhe dokumentacioni provues që kërkuesit i është ofruar zgjidhja e problematikës së parashtruar.
- Rekomandohet bashkëpunimi edhe me qendrat e tjera të shërbimit të ndihmës juridike parësore të administruara nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas.
- Të synohet rritja e numrit të rasteve që adresohen pranë qendrave.

Nga monitorimet e kryera gjatë viti 2022 vërehet se ndihma juridike parësore ka konsistuar në rastet më të shumta në dhënien e ndihmës për të kërkuar ndihmë juridike dytësore, më pas në rastet e dhënies së këshillimit dhe informimit në lidhje me aktet normative në fuqi të drejtat dhe detyrimet e qytetarëve dhe metodat për ushtrimin e këtyre të drejtave. Ndhma Juridike Parësore nga Qendra përveç se shërbimeve të mësipërme, ka evidentuar dhe dhënien e ndihmës juridike të hartimit dhe përpilimit të dokumenteve të nevojshme drejtuar organeve shtetërore, por ky shërbim duhet të vijojë përfshirë dhe përfaqësimin përpara organeve administrative, deri në zgjidhjen e rasteve të paraqitura nga qytetarët pranë QNJF.

4.2 Monitorimi i cilësisë së ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike dytësore

Sipas hartimit dhe miratimit të Kalendarit të Monitorimeve për vitin 2022 me Urdhërin e Drejtorit të Përgjithshëm Nr. 23, datë 10.02.2022, protokolluar me 386 prot., datë 10.02.2022;

Monitorimi fillestar i avokatëve është kryer nëpërmjet përcjelljes së dokumentacionit nga ana e avokatëve sipas kriterëve të vlerësimit, të metodologjisë dhe procedurave të mbikqyrjes. Ky proces ka vijuar, në zbatim të Urdhërit nr. 531, datë 25.11.2019, *"Për miratimin e kriterëve dhe metodologjinë për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikqyrjes nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas të shërbimeve të ndihmës juridike"*, dhe VKM-së Nr. 160, datë 14.03.2022, *"Për reduktimin e shpenzimeve të transportit për funksionarët, nëpunësit, punonjësit e institucioneve të administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministratave dhe Shoqërive/Ndërmarrjeve me kapital shtetëror"*.

Gjithashtu, duke ju referuar shkresës tonë nr. 465/2 Prot., datë 18.05.2022, me lëndë *"Kërkesë për miratimin e autorizimeve për lëvizjet e punonjësve jashtë qendrës së punës"*, nuk ka qenë e mundur realizimi i monitorimeve fillestare në ambientet e ushtrimit të profesionit të secilit avokat deri në përgjigje të shkresës në të cilën komunikohet urdhëri nr. 234, datë 24.05.2022, *"Për delegim kompetence"*, Drejtorit të Përgjithshëm të DNJF-së në autorizimin e punonjësve për kryerjen e shërbimeve brenda vendit, jashtë qendrës së punës është vijuar me monitorimet në vazhdimësi.

- Monitorimi fillestar për avokatët e DHVA Tiranë, referuar Memos me nr.1172/11 Prot., datë 28.06.2022.
- Monitorimi fillestar për avokatët e DHVA Durrës, referuar Memos me nr.1173/6 Prot., datë 23.06.2022.
- Monitorimi fillestar për avokatët e DHVA Fier, referuar Memos me nr.1175/4 Prot., datë 23.06.2022.

- Monitorimi fillestar për avokatët e DHVA Lushnje, referuar Memos me nr.1176/3 Prot., datë 28.06.2022.
- Monitorimi fillestar për avokatët e DHVA Shkodër, referuar Memos me nr.1190/4 Prot., datë 28.06.2022.
- Monitorimi fillestar për avokatët e DHVA Berat, referuar Memos me nr.1201/1Prot., datë 28.06.2022.
- Monitorimi fillestar për avokatët e DHVA Pogradec, referuar Memos me nr.1202/1 Prot., datë 28.06.2022.
- Monitorimi fillestar për avokatët e DHVA Korçë, referuar Memos me nr.1203/4 Prot., datë 28.06.2022.
- Monitorimi fillestar për avokatët e DHVA Elbasan, referuar Memos me nr.1204/3 Prot., datë 28.06.2022.
- Monitorimi fillestar për avokatët e DHVA Vlorë, referuar Memos me nr.1205/3 Prot., datë 28.06.2022.
- Monitorimi fillestar për avokatët e DHVA Gjirokatrër, referuar Memos me nr.1213/1 Prot., datë 28.06.2022.
- Monitorimi fillestar për avokatët e DHVA Lezhë, referuar Memos me nr.1214/3 Prot., datë 28.06.2022.
- Monitorimi fillestar për avokatët e DHVA Kukës, referuar Memos me nr.1234/2 Prot., datë 28.06.2022.
- Monitorimi fillestar për avokatët e DHVA Dibër, referuar Memos me nr.1240/2 Prot., datë 28.06.2022.
- Monitorimi fillestar për avokatët e DHVA Sarandë, referuar Memos me nr.1241/1 Prot., datë 28.06.2022.
- Nga procesi i monitorimit të avokatëve për secilën DHVA janë hartuar memot e sipërcituara lidhur me vlerësimin e të gjitha IKV-ve sipas metodologjisë.

Në vijim të vlerësimit dhe mbikëqyrjes së ofrimit të shërbimit nga avokatët është realizuar monitorimi i vazhdueshëm i avokatëve të DHVA sipas urdhrave të mëposhtëm:

- Monitorimi u avokatëve të DHVA Dibër, sipas urdhërit nr. 277, datë 25.08.2022. *"Për Mbikëqyrjen dhe Kontrollin e Performancës së Ofruesve të Ndihmës Juridike Dytësore, Qarku Dibër"*, realizuar me Memo nr. 1683/2/4 Prot., datë 12.09.2022.
- Monitorimi i avokatëve të DHVA Lezhë, sipas urdhërit nr. 285, datë 13.09.2022. *"Për Mbikëqyrjen dhe Kontrollin e Performancës së Ofruesve të Ndihmës Juridike Dytësore, Qarku Lezhë"*, realizuar me Memo nr. 1715/1 Prot., datë 19.09.2022.
- Monitorimi i avokatëve të DHVA Fier, sipas urdhërit nr. 286, datë 13.09.2022. *"Për Mbikëqyrjen dhe Kontrollin e Performancës së Ofruesve të Ndihmës Juridike Dytësore, Qarku Fier"*, realizuar me Memo nr. 1716/2 Prot., datë 26.09.2022.
- Monitorimi i avokatëve të DHVA Durrës, sipas urdhërit nr. 334, datë 04.10.2022. *"Për Mbikëqyrjen dhe Kontrollin e Performancës së Ofruesve të Ndihmës Juridike Dytësore, Qarku Durrës"*, realizuar me Memo nr. 1823/1 Prot., datë 07.10.2022.
- Monitorimi i avokatëve të DHVA Tiranë, sipas urdhërit nr. 334, datë 04.10.2022. *"Për Mbikëqyrjen dhe Kontrollin e Performancës së Ofruesve të Ndihmës Juridike Dytësore, Qarku Tiranë"*, realizuar me Memo nr. 1822/1 Prot., datë 14.10.2022.

- Është realizuar procesi i monitorimit fillestar dhe i vazhdueshëm për ofruesit e ndihmës juridike dytësore, që përbëjnë Listën e Avokatëve të Dhomave Vendore duke konstatuar dhe vlerësuar cilësinë në ofrimin e shërbimit nga ana e secilit avokatë sipas IKV-ve të metodologjisë. Janë përcjellë rekomandimet përkatëse nga mbikëqyrja e ofrimit të shërbimit në lidhje me përshtatjen e zyrave për personat me aftësi të kufizuar dhe të moshuarve, në lidhje me mbajtjen e arkivit në mënyrë të unifikuar, etj. Rekomandimet janë të pasqyruara në formularët 4 “Për vlerësimin e performancës për ndihmen juridike dytësore” dhe 6 “Për vlerësimin të strukturës organizative të ndihmës juridike dytësore”.
- Raportet e Vlerësimi të ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike dytësore për periudhën Janar-Dhjetor 2022 ka konkluduar me pagesën e ofruesve të ndihmës juridike dytësore për **289** vendime gjyqësore për ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike dytësore.
- **23 Raporte Vlerësimi janë konstatuar për mospagesë ndaj ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike dytësore dhe konkretisht:**
 1. Urdhër nr. 374, dt 28.10.2022 për moskryerjen e pagesës të Av. M.Derti për shërbimin e NJ dytësore për çështjen e V.Gjata;
 2. Urdhër nr. 376, datë 28.10.2022 për moskryerjen e pagesës të ekspertes A.Garipi për shërbimin e NJ dytësore për çështjen e përfitueses;
 3. Udhër nr 383, datë 03.11.2022 për moskryerjen e pagesës të Av. I.Grazhdani për shërbimin e NJ dytësore për çështjen përfitueses A.Terolli.
 4. Urdhër nr. 396, datë 14.11.2022 për moskryerjen e pagesës së Av. A.Lika për shërbimin e NJ dytësore për çështjen e përfituesit H.Hylli.
 5. Urdhër nr. 442, datë 12.12.2022 për moskryerjen e pagesës për ekspertin D.Maliqi për shërbimin e NJ dytësore ndaj përfitueses B.Zotaj.
 6. Urdhër nr. 444, datë 14.12.2022 për moskryerjen e pagesës të Av. U.Gjergji për shërbimin e NJ dytësore ndaj përfitueses D.Dedushi.
 7. Urdhër 78, datë 12.04.2022 për moskryerjen e pagesës të Av. E.Jakova për shërbimin e NJ dytësore në çështjen e përfituesit D.Hutaj.
 8. Urdhër 79, datë 12.04.2022 për moskryerjen e pagesës të Av. A.Kajmaku për shërbimin e NJ dytësore në çështjen e përfituesit I.Gjoni.
 9. Urdhër nr. 83, datë 14.12.2022 për moskryerjen e pagesës të Av. Sh.Marinaj për shërbimin e NJ dytësore në çështjen e përfitueses Xh.Llanaj.
 10. Urdhër nr. 109, datë 10.05.2022 për moskryerjen e pagesës së Av. Z.Lusha për çështjen e përfitueses L.Kryekuti.
 11. Urdhër nr. 114, datë 13.05.2022 për moskryerjen e pagesës të Av. U.Fejzulla për shërbimin e NJ dytësore në çështjen e përfituesit A.Koçi.
 12. Urdher nr. 115, datë 13.05.2022 per moskryerjen e pageses të Av. U.Fejzulla per sherbimin e NJ dytesore ne çeshtjen e perfituesit A.Meçja.
 13. Urdhër nr. 163, datë 15.06.2022 për moskryerjen e pagesës të Av. P.Jaku për shërbimin e NJ dytësore ne çeshtjen e perfituesit V.Matushi.
 14. Urdhër nr. 164, datë 15.06.2022 për moskryerjen e pagesës të Av. A.Rusi për shërbimin e NJ dytësore ne çeshtjen e perfituesit F.Kopani.
 15. Urdhër nr. 192, datë 30.06.2022 për moskryerjen e pagesës të Av.P.Jaku për shërbimin e NJ dytësore ne çeshtjen e perfituesit Gj.Makaj.

16. Urdhër 264, datë 18.08.2022 për moskryerjen e pagesës së Av. E.Lada për shërbimin e NJ dytësore për çështjen e përfituesit Gj.Vathaj.
17. Urdhër 268, datë 22.08.2022 për moskryerjen e pagesës të Av. I.Zoto për shërbimin e NJ dytësore në çështjen e përfitueses M.Kojdheli.
18. Urdhër 282, datë 13.09.2022 për moskryerjen e pagesës të Av. R.Saliaj për shërbimin e NJ dytësore në çështjen e përfituesit F.Jonuzi.
19. Urdhër nr. 283, datë 13.09.2022 për moskryerjen e pagesës të Av. L.Doda për shërbimin e NJ dytësore në çështjen e përfituesit S.Mera.
20. Urdhër nr. 456, datë 23.12.2022 për moskryerjen e pagesës të Av. S.Sulkja për shërbimin e NJ dytësore për çështjen e përfitueses S.Çela.
21. Urdhër 457, datë 28.12.2022 për moskryerjen e pagesës për ekspertin V.Bardhushi për shërbimin e NJ dytësore ndaj përfituesit P.Gjona.
22. Urdhër 458, datë 28.12.2022 për moskryerjen e pagesës të Av. K.Meçaj për shërbimin e NJ dytësore ndaj përfituesit B.Muhametaj.
23. Urdhër nr. 77, datë 12.04.2022 për moskryerjen e pagesës të Av. U.Fejzulla për shërbimin e NJ dytësore në çështjen e përfituesit B.Jupe.

5. Ndërgjegjësimi i publikut mbi sistemin e ndihmës juridike

Ndihma juridike e garantuar nga shteti është një nga format më thelbësore të aksesit në drejtësi që çdo shtet duhet ta garantojë në mënyrë efëçente dhe efektive.

Ligji nr.111/2017, "Për Ndhimën Juridike të Garantuar nga Shteti", ka si qëllim të sigurojë akses të barabartë në drejtësi përmes garantimit dhe funksionimit të sistemit të ndihmës juridike falas. Ky sistem garanton ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike në mënyrë profesionale, cilësore, efëçente dhe efektive.

Në këtë ligj, përcaktohen detyrat dhe kompetencat e Drejtorisë së Ndhimës Juridike Falas, disa prej të cilave janë: mbledhja dhe analiza e informacionit mbi dhënien e ndihmës juridike dhe organizimi i fushatave për rritjen e ndërgjegjësimit publik mbi ofrimin e ndihmës juridike dhe kushtet për përfitimin e saj; bashkëpunimi me Organizata Ndërkombëtare, me Klinika Ligjore dhe me Organizata Jofitimprurëse me qëllim zhvillimin e sistemit të ndihmës juridike, nëpërmjet rritjes së ndërgjegjësimit dhe edukimit ligjor të publikut.

5.1 Zhvillimi dhe pjesëmarrja në takime/aktivitete ndërgjegjësuëse

Për vitin 2022 janë zhvilluar **286 takime/aktivitete ndërgjegjësuëse** ndër të cilat 215 aktivitete të përbashkëta mes ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike/përfaqësuesve të institucioneve në nivel vendor/qendror dhe institucioneve të pavarura të listuara në tabelën si vijon:

Aktivitetet e realizuara përgjatë vitit 2022 nga DNJF dhe Qendrat e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore

Tiranë

1. **Datë 07.09.2022**, Aktivitet i zhvilluar me punonjësit e kompanisë “Krik Krak”, informimi i punonjësve dhe shpërndarja e fletëpalosjeve.
2. **Datë 16.09.2022**, Aktivitet i zhvilluar me qytetarët e komunitetit rom në rrugën “Teodor Keko”, informim i qytetarëve dhe shpërndarje e fletëpalosjeve.
3. **Datë 27.09.2022**, Aktivitet i zhvilluar me qendrën komunitare “ Qëndrojmë së Bashku” ne Kombinat, informim i moshave të treta dhe shpërndarje e fletëpalosjeve.
4. **Datë 04.10.2022**, Aktivitet i zhvilluar me Qendrën Kombëtare të Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje, në Kamëz, informim dhe përfitimin e avokatit falas për viktimat e dhunës në familje.
5. **Datë 13.10.2022**, Aktivitet i zhvilluar me Qendrën Kombëtare Pritëse të Viktimave të Trafikimit në Linzë, informim dhe përfitim avokat falas për viktimat e trafikimit.
6. **Datë 12.12.2022**, Aktivitet i zhvilluar me FSHDPAK, ‘Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar “, informim i personave me aftësi të kufizuar dhe shpërndarje fletëpalosje.

Durrës

1. **Janar 2022**- Aktiviteti ndëgjegjësues në bashkëpunim me shoqatën “Të ndryshëm, por të barabartë”, me temë: “Rritja e aksesit në drejtësi për viktimat e krimit nëpërmjet ofrimit të ndihms juridike falas për gratë dhe burrat në Shqipëri”.
2. **Janar 2022**- Aktiviteti ndëgjegjësues në bashkëpunim me fondacionin “Së bashku”, me temë: “Ndhma juridike falas për personat me aftësi të kufizuara”.
3. **Shkurt 2022**- Ministri i Drejtësisë, z. Ulsi Manja, mbikqyri nga afër punën e punonjësve të Qendrës së Ndhmës Juridike Parësore Durrës, ku u takua drejtpërdrejtë me qytetarët përfitues të kësaj Qendre.
4. **22 Shkurt 2022**- Punonjësit e Qendrës së Ndhmës Juridike Parësore Durrës në bashkëpunim me DNJF organizuan sesionin e trajnimit të studentëve të UAMD për ndihmë juridike të garantuar nga shteti.
5. **24 Qershor 2022**- Aktiviteti ndëgjegjësues stret law, në bashkëpunim me shoqatën “Për integrimin e egjiptianëve dhe romëve”, me temë: “Rritja e aksesit në drejtësi për komunitetin romë dhe egjiptian nëpërmjet ofrimit të ndihms juridike falas”.
6. **09 Shtator 2022**- Aktiviteti ndëgjegjësues në bashkëpunim me Njësinë Administrative Nr.3, Durrës me temë: “Edukimi ligjor, mjet për rritjen e aksesit në drejtësi të qytetarve të Durrësit, në mënyrë të vecantë grupeve në nevojë në sistemin e drejtësisë”, aktivitet në të cilën morën pjesë edhe qytetarë që marrin shërbim pranë kësaj Njësie.
7. **16 Shtator 2022**- Aktiviteti ndëgjegjësues në bashkëpunim me Qendrën Multifunkionale Nishtulla Durrës me temë: “Edukimi ligjor, mjet për rritjen e aksesit në drejtësi të qytetarve të Durrësit, në mënyrë të vecantë grupeve në nevojë në sistemin e drejtësisë”, aktivitet në të cilën morën pjesë edhe qytetarë që marrin shërbim pranë kësaj Qendre.

8. **23 Shtator 2022**- Aktiviteti ndëgjegjësues në bashkëpunim me Zyrën për Barazinë Gjinore dhe Dhunën në familje, Bashkia Durrës me temë: “Edukimi ligjor, mjet për rritjen e aksesit në drejtësi të qytetarve të Durrësit, në mënyrë të vecantë grupeve në nevojë në sistemin e drejtësisë”, aktivitet në të cilën morën pjesë edhe qytetarë që marrin shërbim pranë kësaj Qendre.
9. **30 Shtator 2022**- Aktiviteti ndëgjegjësues në bashkëpunim me Njësinë Administrative Nr.2, Durrës me temë: “Edukimi ligjor, mjet për rritjen e aksesit në drejtësi të qytetarve të Durrësit, në mënyrë të vecantë grupeve në nevojë në sistemin e drejtësisë”, aktivitet në të cilën morën pjesë edhe qytetarë që marrin shërbim pranë kësaj Njësie.
10. **30 shtator 2022** - Aktiviteti ndëgjegjësues në bashkëpunim Qendrën Ditore të të Moshuarve pranë Kryqit të Kuq Durrës me temë: “Edukimi ligjor, mjet për rritjen e aksesit në drejtësi të qytetarve të Durrësit”, aktivitet në të cilën morën pjesë edhe qytetarë që marrin shërbim pranë kësaj Qendre.
11. **11 Tetor 2022**- Aktiviteti ndëgjegjësues në bashkëpunim me Qendrën e Shërbimeve mbrojtëse, fuqizuese dhe Emergjente për fëmijët dhe Familjen Durrës, me temë: “Edukimi ligjor, mjet për rritjen e aksesit në drejtësi të viktimave të dhunës në familje, viktimave të trafikimit etj.”, aktivitet në të cilën morën pjesë edhe viktima të trafikimit.
12. **11 Tetor 2022**- Qendra e Ndihmës Juridike Parësore Durrës mori pjesë në aktivitetin për promovimin e Zyrës Rajonale të Ndërmjetësimit Durrës, ku u lidh një marrëveshje bashkëpunimi midis këtyre dy institucioneve, me qëllim përfshirjen e ndërmjetësimit falas të qytetarëve përfitues të Qendrës.
13. **17 Tetor 2022**- Aktiviteti ndëgjegjësues në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Policisë Durrës me temë: “Edukimi ligjor, mjet për rritjen e aksesit në drejtësi të viktimave të dhunës në familje, viktimave të trafikimit etj.”, aktivitet në të cilën morën pjesë edhe qytetarë. Fokus i këtij aktiviteti ishin viktimat e dhunës në familje dhe viktimat e trafikimit. Gjatë këtij aktiviteti u lidh një urë bashkëpunimi ndërinstytucional.
5. **12.10.2022**, Aktiviteti ndërgjegjësues pranë “Fondacionit “Joscelyn”, (takim me drejtuesin, informim i qytetarëve, shpërndarje fletëpalosjesh dhe referimi i rasteve pranë qendrës Elbasan).
6. **12.10.2022**, Aktiviteti ndërgjegjësues pranë shkollës profesionale “Ali Myftiu”, Elbasan, (takim me drejtuesin,informim i nxenesve, shpërndarje fletëpalosjesh dhe referimi i rasteve pranë qendrës Elbasan)
7. **26.10.2022**, Aktiviteti ndërgjegjësues pranë shoqatës “ Lëvizja Rinore Egjiptiane dhe Rome”, Elbasan (takim me drejtuesin dhe punonjesit, informim i qytetareve, shpërndarje fletëpalosjesh dhe referimi i rasteve pranë qendrës Elbasan)
8. **27.10.2022**, Aktiviteti ndërgjegjësues pranë “Tregut Rom në qytetin e Elbasanit”, (informim i qytetarëve, shpërndarje fletëpalosjesh dhe referimi i rasteve pranë qendrës Elbasan).
9. **28. 10. 2022** , Aktiviteti ndërgjegjësues, pranë fasonerisë “Eria Textiles”, (informim i punonjesve, shpërndarje fletëpalosjesh dhe referimi i rasteve pranë qendrës Elbasan).
10. **28.10.2022**, Aktiviteti ndërgjegjësues, pranë “Fondacioni Joscelyn”(takim përmbyllës, informim i grave dhe vajzave te pranishme, shpërndarje fletëpalosjesh dhe referimi i rasteve pranë qendrës Elbasan)
11. **18.11.2022**, Aktiviteti ndërgjegjësues pranë Gjimnazit “Mahir Domi”, (takim me drejtoreshen, punonjesen sociale dhe aktivitet informues me nxënësit, shpërndarje fletëpalosjesh dhe referimi i rasteve pranë qendrës Elbasan)

12. **14.12.2022**, Aktiviteti ndërgjegjësues pranë "Qendrës Multifunkionale Balashe"(takim me drejtuesin dhe punonjesit, informim i qytetarëve të strehuar në qender, shpërndarje fletëpalosjesh dhe referimi i rasteve pranë qendrës Elbasan.)

Korçë

1. **Dhjetor 2022** Aktivitet mbi hapjen e Qendrës së Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Korçë

Berat

1. Aktivitet pranë Drejtorisë Vendore të Policisë **Berat**.
2. Aktivitet pranë "Shtëpisë së përbashkët "në varësi të Këshillit të Qarkut **Berat**.
3. Aktivitet pranë Drejtorisë së Shërbimit Social, Berat.
4. Aktivitet pranë Fasonerisë "Malotex" tekstile, Berat.
5. Aktivitet pranë Qendrës multifunkionale Komunitare, në varësi të Shërbimit Social, Berat.
6. Aktivitet pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore **Berat**.
7. Aktivitet pranë Qendrës Rinore Berat, (Takim me nxënësit e shkollave të mesme.)
8. Takim me viktimat e dhunës në ambjentet e Qendrës multifunkionale komunitare, Berat.
9. Takim me nxënësit e shkollës së mesme " Babë Dudë Karbunara", Berat.
10. Aktivitet informues dhe ndërgjegjësues mbi ligjin nr.111/2017 "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti" me komunitetin rom, në Qendrën multifunkionale komunitare, Berat.

5.2 Zhvillimi i intervistave televizive në kuadër të promovimit të sistemit të ndihmës juridike, edukimit ligjor të publikut

Përgjatë vitit 2022, nga ana e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas janë zhvilluar 8 intervista televizive në kuadër të promovimit të sistemit të ndihmës juridike, edukimit ligjor të publikut të listuara si më poshtë vijon:

Janë zhvilluar 7 intervista televizive në televizionet lokale nga Qendrat e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore.

Zhvilluar **një intervistë** në Radio Televizionin Publik Shqiptar të Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas.

Përgjatë vitit 2022, nga ana e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas janë zhvilluar intervista televizive në kuadër të promovimit të sistemit të ndihmës juridike, edukimit ligjor të publikut të listuara si më poshtë vijon:

1. Reportazh informativ lidhur me funksionimin e Qendrës së Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Pogradec i dhënë në kanal televiziv lokal SOT& Pogradec
<https://youtu.be/3gCXspvQEJs>

2. Realizuar intervista televizive nga punonjësit e Qendrës së Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Pogradec në muajin prill në televizionin lokal Televizioni SOT7
<https://youtu.be/7c3mhX-hcEo>
3. Realizuar intervista televizive nga punonjësit e Qendrës së Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Pogradec në muajin shtator në televizionin lokal Televizioni SOT7
<https://youtu.be/gkAshYIA0ëE>
4. Më datë 29.01.2022, realizuar intervista televizive nga punonjësit e Qendrës së Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Gjirokastër në televizionin lokal Televizioni RTGJ Gjirokastër.
<https://www.youtube.com/ëatch?v=qT9rbPm34Zc>
5. Më datë 23.05.202, realizuar intervista televizive nga punonjësit e Qendrës së Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Gjirokastër me television Zëri i Amerikës (Zëriamerikës).
https://www.youtube.com/ëatch?v=-uq3NvË_ËY8
6. Realizuar intervista televizive nga punonjësit e Qendrës së Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Gjirokastër në television lokal RTGJ, më datë 04.08.2022, (Përforsim i shërbimeve ligjore për qytetarët në nevojë, asistencë juridike, zgjidhja e çështjeve pa kosto dhe tarifa).
<https://www.youtube.com/ëatch?v=s7qËe3s5YpY&t=27s>
7. Realizuar intervista televizive më datë 01.04.2022 nga punonjësit e Qendrës së Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Shkodër në televizionin lokal TV1 Channel.

5.3 Nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet në nivel qendror dhe vendor si dhe me organizata jofitimpruesë që operojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të qytetarëve.

Përgjatë vitit 2022, në kuadër të forcimit të bashkëpunimit me institucionet e tjera që kanë në fokus të tyre mbrojtjen e të drejtave ligjore të qytetarëve është bërë e mundur **nënshkrimi i 17 (shtatëmbëdhjetë) marrëveshjeve të bashkëpunimit** *“Për sigurimin e aksesit në drejtësi të qytetarëve nëpërmjet ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike falas sipas përcaktimeve të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti””* dhe konkretisht:

1. Marrëveshje bashkëpunimi nr.974/1 Prot, datë 14.04.2022 me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi;
2. Marrëveshje bashkëpunimi nr. 1002 Prot, datë 20.12.2021 me Bashkinë Berat;
3. Marrëveshje bashkëpunimi nr. 1105/7 Prot, datë 09.06.2022 me Bashkinë Gjirokastër;
4. Marrëveshje bashkëpunimi nr. 821/1 Prot, datë 23.03.2022 me Bashkinë Kukës;
5. Marrëveshje bashkëpunimi nr. 820/1 Prot, datë 23.03.2022 me Bashkinë Korçë;
6. Marrëveshje bashkëpunimi nr.1106 Prot, datë 09.05.2022 me Caritas Shqiptar;
7. Marrëveshje bashkëpunimi nr. 332 Prot, datë 04.02.2022 me Universitetin Epoka;
8. Marrëveshje bashkëpunimi nr. 1104/6, datë 08.06.2022 me Këshillin e Qarkut Fier,
9. Marrëveshje bashkëpunimi nr.1195/1 Prot, datë 23.05.2022 Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan;

10. Marrëveshje bashkëpunimi nr.398/1 Prot, datë 14.02.2022 me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës;
11. Marrëveshje bashkëpunimi nr. 399/1 Prot, 14.02.2022 me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër;
12. Marrëveshje bashkëpunimi nr. 1797/1 Prot, datë 28.09.2022 me Drejtorinë e Kujdesit Social Bashkia Lezhë;
13. Marrëveshje bashkëpunimi nr.1103 Prot, datë 09.05.2022 me Organizatën "Vatra";
14. Marrëveshje bashkëpunimi nr. 1174 Prot, datë 20.05.2022 me ISSH Gjirokastrë;
15. Marrëveshje bashkëpunimi nr. 1850 Prot, datë 10.10.2022 me Qendrën Evropiane;
16. Marrëveshje bashkëpunimi nr. 1993 Prot, datë 03.11.2022 me Qendrën për Fuqizimin Ligjor;
17. Marrëveshje bashkëpunimi nr. 2096/2 Prot, datë 23.11.2022 me Fondacionin "Joscelyn".

Qëllimi i këtyre marrëveshjeve konsiston kryesisht në bashkëpunimin e palëve sa i përket:

- ✓ Promovimit të sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti përmes zhvillimit të aktiviteteve të përbashkëta sensibilizuese; edukimit ligjor apo afishimit të materialeve të vizibilitetit;
- ✓ Shkëmbimit të përvojës në kuadër të përmirësimit të politikave shtetërore në fushën e ndihmës juridike;
- ✓ Zhvillimit të takimeve për të diskutuar çështjet me interes të përbashkët;
- ✓ Planifikimit dhe organizimit të trajnimeve të përbashkëta në këtë kuadër;
- ✓ Kryerjes së analizave dhe studimeve të përbashkëta me qëllim nxjerrjen e rekomandimeve të karakterit ligjor dhe administrativ dhe vënien e tyre në dispozicion të palëve, të cilat do të vlerësojnë nevojën dhe formën e ndërhyrjeve konkrete bazuar në kompetencat ligjore.
- ✓ Krijimit të hapsirave të nevojshme në lidhje me publicitetin e ndihmës juridike falas që ofrohet për shtresat në nevojë.
- ✓ Informimit periodikisht nga ana e DNJF, në lidhje me aktet e dala në funksion të ligjit.

6. Trajnimi i ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe dytësore

6.1 Bashkëpunimi me Caritas Shqiptar (Trajnimi i ofruesve të ndihmës juridike parësore)

Në muajin Korrik 2022, Drejtorja e Ndihmës Juridike Falas, në kuadër të bashkëpunimit me organizatën Caritas Shqiptar me të cilën ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi, zhvilloi trajnimin me temë: "Forcimi i kapaciteteve të aktorëve që ofrojnë ndihmën juridike parësore për garantimin e aksesit të barabartë në sistemin e drejtësisë të azilkërkuesve dhe refugjatëve në Shqipëri".

Ky trajnim pati si qëllim garantimin e një shërbimi ligjor efektiv të target grupit që parashikohen në Ligjin 111/2017 "Për Ndhimën Juridike të Garantuar nga Shteti", konkretisht Neni 10, pika 1, shkronja ç : Azilkërkuesit, personat që gëzojnë statusin e refugjatit dhe personat që janë në process ankimi të vendimeve administrative dhe/ ose gjyqësore për refuzimin e aplikimit për azil ose revokimin e vendimit të statusit të refugjatit, sipas legjislacionit në fuqi për azilin në Republikën e Shqipërisë.

Morën pjesë punonjësit e Qendrave të Shërbimit të Ndhimës Juridike Parësore,

përfaqësues të OJF-ve të autorizuara nga Ministri i Drejtësisë dhe studentë të angazhuar pranë Klinikave të Ligjit me të cilët DNJF ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi. Në fund pjesëmarrësit u pajisën me certifikata.

6.2 Sa i përket trajnimit të ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike parësore

Zhvillimi i trajnimeve për punonjësit me trajnim të posaçëm, është një detyrim ligjor i parashikuar në shkronjën "g", të nenit 8 të ligjit nr.111/2017.

Në vijim të praktikës së ndjekur përgjatë vitit 2021, DNJF kërkoi nga ana e UNDP dhe Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA) mbështetjen për zhvillimin e këtyre trajnimeve.

Në kuadër të këtij bashkëpunimi, përgjatë periudhës **Nëntor-Dhjetor 2022, u bë i mundur zhvillimi i kursit online "Ndhima juridike parësore e garantuar nga shteti"** si pjesë e Projektit "*Shtrirja e shërbimit të ndihmës juridike për gratë dhe burrat në Shqipëri*" zbatuar nga UNDP në partneritet me Ministrinë e Drejtësisë dhe me financim të Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim (ADC).

Kursi online trajtoi:

- Shërbimin e ndihmës juridike parësore falas si një hap me rëndësi në rritjen e kapaciteteve të ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike parësore falas në kuadër të ofrimit të këtij shërbimi për të gjithë kategoritë vulnerabel të përcaktuara në Ligjin 111/2017 "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti";
- Familjarizimin e ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike parësore me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi që rregullon shtrirjen, përmbajtjen dhe metodologjinë e ofrimit të ndihmës ligjore.

Me zhvillimin e këtij trajnimi u bë e mundur përmbushja e detyrimit ligjor të trajnimit të detyrueshëm të qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore të cilët nuk i ishin nënshtruar trajnimit përgjatë vitit 2021.

6.3 Sa i përket trajnimit të ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike dytësore

Referuar nenit 9 pika "d" të ligjit nr. 111/2017 "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti" parashikon se: **Dhoma Kombëtare e Avokatisë, përgatit dhe organizon programet e trajnimit të vazhdueshëm për avokatët e përfshirë në listën e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore, në bashkëpunim me Drejtorinë e Ndhimës Juridike Falas.**

Me qëllim asistimin e avokatëve në procesin e dhënies së ndihmës juridike dytësore, raportimit për sa i përket ndjekjes së çështjeve; ndërveprimit të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas me Dhomat Vendore të Avokatisë si dhe të shkëmbimit të konsideratave, përgjatë vitit 2022, janë zhvilluar sesione të dedikuara për ndihmën juridike dytësore si rezultat si një bashkëpunimi ndërmjet UNDP, ADC, DHASH, MD dhe Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas.

Konkretisht, në zbatim të detyrave ligjore DHKA në bashkëpunim me DNJF kanë organizuar trajnimet e mëposhtme.

- Më datë 26-27 Maj 2022 dhe më datë 13 -14 Shtator 2022 janë zhvilluar trajnimet për avokatët e përfshirë në listën e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore në DHVA Tiranë.
- Më datë 20-21 Tetor 2022 janë zhvilluar trajnimet për avokatët e përfshirë në listën e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore në DHVA Pogradec/Elbasan dhe Korçë.
- Më datë 21-22 Dhjetor 2022 janë zhvilluar trajnimet për avokatët e përfshirë në listën e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore në DHVA Vlorë/Fier/Sarandë dhe Gjirokastër.
- Më datë 14-15 Nëntor 2022 janë zhvilluar trajnimet për avokatët e përfshirë në listën e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore në DHVA Shkodër/Lezhë dhe Kukës.

7. Kontribute dhe raportime të DNJF-së në kuadër të proceseve strategjike

7.1 Angazhim i DNJF në kuadër të Strategjisë për Edukimin Ligjor të Publikut (SELP).

Strategjia për Edukimin Ligjor të Publikut 2019-2023, është një instrument i rëndësishëm me fokus parashikimin e masave konkrete mbi informimin dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve. Është pikërisht Plani i Veprimit në zbatim të kësaj strategjie, dokumenti në të cilin përmbledhen të gjitha aktivitetet dhe masat në përmbushje të objektivave strategjike. Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas është një nga institucionet e përfshira në këtë plan masash.

Në këtë plan janë parashikuar disa masa konkrete që synojnë të mbështesin dhe informojnë komunitetet romë dhe egjiptianë në përputhje me nevojat e tyre. Konkretisht, DNJF ndër të tjera, është përgjegjëse për masat nën objektivat si vijon:

Objektivi Specifik 2.3: Konkretizimi i bashkëpunimit ndërinstitucional nëpërmjet realizimit të iniciativave të përbashkëta të ELP-së.

- 2.3.2 Instrumentet për veprimtaritë dhe bashkëpunimin në fushën e ndihmës juridike falas në nivel qendror dhe nivel vendor, të përmirësuara.
- 2.3.2 Hartimi dhe nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me OSHC-të, Klinikave të Ligjit për ofrimin e ndihmës juridike falas (kontrata bashkëpunimi).

Objektivi specifik 4.1: Rritja e aksesit të publikut në informacionin ligjor dhe pasurimi i vazhdueshëm i njohurive juridike të tyre në përputhje me nevojat specifike.

- 4.1.1 Hartimi i materialeve që fokusohen në tema të veçanta ligjore dhe/ose me interes për grupe të qytetarëve me nevoja të veçanta, në formate të përshtatshme lehtësisht të aksesueshme.
- 4.1.1 Vlerësim mbi nevojat prioritare dhe imediate të qytetarëve për ELP-të(I) Identifikimi i autoriteteve kryesore qendrore dhe vendore të cilat duhet të përmbledhin informacion ligjor në gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme për publikun, sipas fushës së tyre të veprimtarisë (II) Mars 2020: Aktivitet ndërgjegjësues/sesion informues mbi sistemin e ndihmës juridike falas për të miturit në Institutin e të Miturve Kavajë (përgatitje fletëpalosjesh, broshura informuese dhe manual mbi sistemin e ndihmës juridike në një gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme) - Brenda vitit 2020: zhvillimi i aktiviteteve/sesioneve të informimit në gjimnaze, duke filluar me qytetin e Elbasani, aty ku është ngritur qendra e ofrimit të ndihmës juridike e duke vijuar me qytetin e Tiranës. (përgatitje e materialeve në një gjuhë të thjeshtë e të kuptueshme).

Aktivitet ndërgjegjësues mbi sistemin e ndihmës juridike falas për gratë e dënuara.

- 4.1.1 b Hartimi i materialeve informuese alternative me grafika, simbole dhe shenja të përshtatura me kategoritë e përfituesve dhe aftësitë e tyre për marrjen e informacionit. Aktivitete që vijnë përgjatë kohës së zbatimit të PV.
- 4.1.3 Mekanizma për të përmirësuar bashkëpunimin e vazhdueshëm me median
- 4.1.3 b Realizimi i programacioneve mediatike/ intervistave dhe diskutimeve në TV kombëtare dhe lokale, si dhe në radio nga anëtarët e Rrjetit me tematika të ndryshme ligjore sipas sektorëve përkatës.

Objektivi specifik 4.2: Informimi dhe ndërgjegjësimi i gjerë i publikut nëpërmjet fushatave mediatike në një fushë ligjore të caktuar apo në trajtimin ligjor të një fenomeni specifik.

- 4.2.1 Mekanizma dhe instrumente të lidhura me informimin dhe ndërgjegjësimin publik, të përmirësuara.
- 4.2.1 a. Fushata ndërgjegjësuese dhe informuese për ligjin nr.111/2017; broshura dhe fletëpalosje specifike në qytete Tiranë, Durrës, Elbasan, etj) Aktivitete që kryhen në vijimësi gjatë viteve të zbatimit të PV;
- 4.2.1 b. Forume të hapura me pjesëmarrje të gjerë qytetare me qëllim marrjen e njohurive ligjore mbi ligjin nr.111/2017, sistemin e ndihmës juridike falas, kushtet/kriteret e përfitimit/subjektet përfitues/shërbimet që ofrohen etj. Aktivitete që kryhen në vijimësi gjatë viteve të zbatimit të PV.

Objektivi specifik 4.6: Rritja e pjesëmarrjes dhe rolit të studentëve të drejtësisë dhe profesionistëve të së drejtës në ELP.

- 4.6.1 Qytetarët të informuar për të drejtat dhe detyrimet e tyre ligjore, nëpërmjet aktiviteteve me studentë të ligjit dhe avokatë të specializuar.
- 4.6.1 a Aktivitete të zhvilluara me studentë të shkencave të komunikimit për të ofruar ELP pranë komuniteteve.

Në kuadër të kësaj Strategjie, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas raporton periodikisht çdo tre muaj si dhe sa herë kërkohet në kuadër të Raporteve të Monitorimit. Gjithashtu, Drejtoria ndjek çdo takim dhe trajnim që zhvillohet në kuadër të Strategjisë për Edukimin Ligjor të Publikut.

- Shkresë nr. 2198/1 prot datë 15.12.2022 me lëndë “Dërgohet kontributi i Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas në kuadër të zbatimit të “Strategjisë për Edukimin Ligjor të Publikut dhe të Planit të saj të Veprimit 2020-2023” për periudhën Janar – Dhjetor 2022.”

7.2 Angazhim i DNJF në kuadër të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë (SND).

Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas është një nga institucionet që garanton aksesin në drejtësi dhe si e tillë ka një kontribut të rëndësishëm në këtë strategji dhe në zbatimin e saj përmes planit të veprimit. Gjatë kësaj periudhe DNJF është angazhuar në raportim mbi masat e parashikuara në planit aktual të veprimit në zbatim të kësaj strategjie si dhe me kontribut e sugjerime konkrete mbi procesin e rishikimit të strategjisë.

Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë 2021-2025 u miratua me vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 823, datë 24.12.2021 “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2021–2025 dhe Planit të Veprimit.

Në kuadër të kësaj Strategjie, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas raporton periodikisht çdo **tre muaj** si dhe sa herë kërkohet në kuadër të Raporteve të Monitorimit. Gjithashtu, Drejtoria ndjek çdo takim dhe trajnim që zhvillohet në kuadër të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë.

Objektivi Specifik: Aksesi efektiv në drejtësi i siguar nëpërmjet ndihmës juridike, zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve dhe tarifave gjyqësore të përshtatshme.

Masat specifike për të cilat Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas raporton:

2.5.1 Informimi dhe rritja e ndërgjegjësimit të subjekteve të ligjit “Për ndihmën juridike falas” për të drejtat e tyre për ndihmë dhe akses në institucione, të cilat mund të zgjidhin mosmarrëveshjet e tyre.

2.5.2 Kryerja e analizës së vlerësimit të nevojave për trajnim të DNJF-së dhe hartimi i planit/ kurrikulave/ programeve të trajnimit.

2.5.3 Trajnimi i nëpunësve të DNJF-së në kuadër të forcimit të kapaciteteve të saj për kryerjen funksioneve të ngarkuara nga kuadri ligjor për ndihmën juridike.

2.5.4 Kryerja e analizës së vlerësimit të nevojave për trajnim të ofruesve të Ndhmës Juridike parësore dhe hartimi i planit/ kurrikulës/ programit të trajnimit.

2.5.5 Trajnimi i ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike parësore në kuadër të rritjes së cilësisë së shërbimit të ofruar.

2.5.6 Kryerja e analizës së vlerësimit të nevojave për trajnim të avokatëve për ofrimin e ndihmës juridike dytësore falas dhe hartimi i planit/kurrikulës/programit të trajnimit.

2.5.7 Trajnimi i avokatëve në kuadër të rritjes së cilësisë së shërbimit të ndihmës juridike falas të ofruar.

2.5.9 Hartimi, konsultimi dhe miratimi i planit të komunikimit të DNJF-së me grupet e tjera të interesit në sektorin gjyqësor.

2.5.16 Sigurimi i mjediseve, infrastrukturës, pajisjeve, mjeteve të transportit, të mjaftueshme dhe të përshtatshme, dhe mbështetje të qëndrueshme buxhetore për funksionimin efektiv të sistemit të DNJF-së.

2.5.17 Sigurimi i burimeve të përshtatshme për operatorët dytësorë DNJF.

Në përfundim të vitit 2022, vlerësojmë që objektivi u realizua në masën 100%.

Pjesëmarrje e DNJF në kuadër të zbatimit të projektit **JUSTAL** "Asistencë teknike për mbështetjen e zbatimit të strategjisë ndërsektoriale të Drejtësisë në Shqipëri", financuar nga Bashkimi Evropian (IPA II), për periudhën kohore 15 Qershor 2022- 14 Qershor 2024.

Qëllimi i projektit konsiston në:

- Forcimin e kapaciteteve të Ministrisë së Drejtësisë për të zbatuar në mënyrë efikase SND-në;
- Asistencë për institucionet e sistemit të drejtësisë për të koordinuar në kuadrin e SND-së dhe plani përkatës të veprimit;
- Asistencë për institucionet e sistemit të drejtësisë për të mbledhur të dhëna dhe për të raportuar mbi rezultatet e zbatimit të SND-së;
- Forcimi i kapaciteteve të institucioneve të sistemit të drejtësisë për të komunikuar mbi reformën në drejtësi dhe rezultatet e zbatimit të SND-së dhe Planit të Veprimit të saj

7.3 Angazhim i DNJF në kuadër të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit dhe Planit të Integritetit

Në kuadër të Planit të Veprimit në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2020-2023, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas nuk ka të parashikuar masa specifike por mbështet Ministrinë e Drejtësisë në të gjitha raportimet e nevojshme. Duke qenë se përballja efektive me korrupsionin për Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas është tepër e rëndësishme për arritjen e rezultateve të larta në forcimin e integritetit institucional, mirëqeverisjen, si dhe ofrimin e shërbimeve më të mira për qytetarët e Republikës së Shqipërisë.

-Urdhër nr. 24 datë 15.02.2022 "Për caktimin e Koordinatorit të Integritetit të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas". Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas ka miratuar Planin e Integritetit me urdhrin nr. 180 datë 22.12.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas. Qëllimi i Planit të Integritetit në këtë institucion është:

- i) vlerësimi i risqeve të integritetit të cilat komprometojnë aftësinë e DNJF për të kryer funksionin e shërbimit publik në mënyrë të paanshme dhe të përgjegjshme dhe i faktorëve që mund të mbështesin apo rrisin risqet e vlerësuara si dhe
- ii) formulimi i masave të përshtatshme për adresimin e tyre.

Si rezultat i procesit të vlerësimit të riskut të integritetit, nëpërmjet këtij Plani Integriteti, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas ka vendosur tre objektiva të realizueshëm brenda periudhës 2022-2024, nëpërmjet të cilëve synohet që të minimizohen dhe adresohen risqet e konstatuara.

Objektivi përfundimtar i këtij plani është ndërtimi i një sistemi të brendshëm efektiv dhe forcimi i kulturës së integritetit institucional.

Objektivat strategjikë 2022-2024 të Planit të Integritetit, janë:

1. Forcimi i mekanizmave të brendshëm rregullatorë dhe të kontrollit;
2. Rritja e efektivitetit në menaxhimin e burimeve njerëzore;
3. Garantimi i transparencës me publikun.

Këto objektiva strategjikë bazohen dhe përputhen me parimet e menaxhimit të riskut të integritetit të MVRI, me vizionin e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, si edhe me paketën e legjislacionit në fushën e anti-korrupsionit, parandalimit të konfliktit të interesit dhe transparencës në sektorin

publik. Këto objektiva do të udhëheqin punën e institucionit përgjatë periudhës së parashikuar, duke angazhuar në mënyrë të drejtpërdrejtë të gjitha strukturat dhe nëpunësit përgjegjës.

Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas hartoi raportin e monitorimit vlerësoi përmbushjen e objektivave sipas afatit kohor të parashikuar.

7.4 Angazhim i DNJF në kuadër të Strategjisë së Drejtësisë për të Miturit (SDM)

Në adresë të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas është përcjellë për mendim *Strategjia Ndërsektoriale të Drejtësisë për të Mitur 2022-2026*. Drejtoria pasi konsultoi të gjitha masat e parashikuara i është drejtuar Ministrisë së Drejtësisë me shkresën nr. 2130/1 datë 07.12.2022 me lëndë "Kthim përgjigje mbi shkresën nr. 4552/3 prot datë 23.11.2022 me lëndë "Dërgohet projektvendimi për mendim".

Në Draft Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë për të Mitur si dhe në Matricën e Masave dhe Aktiviteteve (2022-2026), Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, është e angazhuar në këto masa:

- 1.1.7.1 Përditësimi i informacionit online, me një gjuhë miqësore për fëmijët për të drejtat dhe shërbimet e drejtësisë miqësore për fëmijë nga çdo institucion- DNJF institucion përgjegjës;
- 1.1.7.2 Përgatitja e informacioneve me gjuhën e shenjave për shërbimet e drejtësisë miqësore për fëmijët nga çdo institucion dhe publikimi i tyre në faqen zyrtare të institucionit- DNJF institucion përgjegjës;
- 1.1.7.3 Hartimi i manualeve dhe videove të thjeshtëzuara dhe me gjuhë miqësore për shërbimet për fëmijët nga çdo institucion shoqëruar me informacion për mënyrën e qasjes në këto shërbime- DNJF institucion përgjegjës;
- 2.3.2.5 Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave statistikore për fëmijët që kanë pasur akses në ndihmën juridike, psikologjike dhe shërbime të tjera sipas pozitës së tyre në proces- DNJF institucion përgjegjës;
- 3.1.1.1 Organizimi i fushatave informuese dhe ndërgjegjësuese në terren në zona ku ka fëmijë më të riskuar për të qenë në kontakt/konflikt me ligjin- DNJF institucion përgjegjës;
- 3.1.1.2 Organizimi i fushatave ndërgjegjësuese për informimin e fëmijëve dhe prindërve për mundësitë e ofrimit të ndihmës juridike falas, me fokus grupet më të dobëta të fëmijëve- DNJF institucion përgjegjës;
- 3.1.1.3 Botimi në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë dhe të qendrave të ndihmës juridike të videove dhe materiale informuese të përgatitura për ndihmën juridike për fëmijën- DNJF institucion përgjegjës;
- 3.1.1.4 Përgatitja me një gjuhë dhe format miqësor, botimi, publikimi dhe shpërndarja e kartës së të drejtave të fëmijës në kontakt/ konflikt me ligjin- DNJF institucion përgjegjës;
- 3.1.1.5 Përgatitja e informacioneve me një gjuhë miqësore për fëmijët në lidhje me procedurat dhe të drejtat e fëmijës në proceset para prokurorisë/ gjykatave- DNJF institucion përgjegjës;
- 3.1.1.6 Ekipet lëvizëse në terren për ofrimin e ndihmës juridike falas nga organizata të licensuara nga MD- DNJF institucion partner;
- 3.1.1.7 Ofrimi i ndihmës juridike parësore nga studentë probono ku ka departamente ose fakultete drejtësie- DNJF institucion partner;
- 3.1.1.8 Informimi i fëmijëve në shkollë në lidhje me ekzistencën dhe shërbimin që ofron linja 08001010 (Linja e gjelbër)/ platforma "Juristi online" - DNJF përgjegjës;
- 3.1.1.9 Ofrimi i ndihmës juridike parësore përmes linjës së dedikuar 08001010 (Linja e gjelbër)/ "Juristi online" (2022-2026)- DNJF përgjegjës.

7.5 Kontribut i DNJF ne kuader te angazhimit ne Planin e Veprimit per Partneritet dhe Qeverisje te Hapur (OGP).

Partneriteti i Qeverisë së Hapur u konsiderua si një mekanizëm i rëndësishëm me synim të qartë për të promovuar nëpërmjet anagzimeve për procese kyçe të zhvillimit strategjik dhe integritimit evropian të vendit. Komponenti 3 “Aksesi në Drejtësi” u parashikuar në Planin Kombëtar të Veprimit të Partneritetit për Qeverisje të Hapur me qëllim për të materializuar, ndërlidhur dhe siguruar qasjen e trefishtë mbi aksesin, transparencën dhe llogaridhënien.

Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas ka kontribuar në raportin e kryer nga Ministria e Drejtësisë mbi zbatueshmërinë e masave të parashikuara për periudhën shtator 2021- shtator 2022 mbi Komponentin nr. 3 “Aksesi në Drejtësi” dhe masës prioritare nr.1: Ndhma Juridike ofrohet në formë efikase e cila u siguron qytetarëve në nevojë, qasje të plotë në një shërbim të tillë.

Aktualisht Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas është në procesin e bashkë-hartimit të Planit të ri Kombëtar të Veprimit, për Partneritet për Qeverisje të Hapur, 2022-2024.

8. Angazhimet e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas në kuadër të procesit të Integritimit Evropian dhe Raportimeve Ndërkombëtare

DNJF si një institucion i dedikuar sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti, është angazhuar që prej fillimit të funksionimit në hartimin e kontributeve të vazhdueshme në kuadër të proceseve që ndiqen me Bashkimin Evropian.

8.1 Kontribut dhe raportime në kuadër të procesit të Integritimit Evropian për progresin e arritur mbi forcimin e aksesit në drejtësi dhe shërbimet ligjore falas:

Në kuadër të procesit të Integritimit Evropian Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas ka raportuar në mënyrë të vazhdueshme sa i përket **Kapitullit 23** “Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore” dhe Kriterit Politik.

Raportimet kryesore të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas:

- Të dhëna statistikore ndër vite (2018-2022);
- Të dhëna specifike për kategoritë përfituese të ndihmës juridike të garantuar nga shteti;
- Përafrimi i legjislacionit dhe aktet nënligjore;
- Kuadri ligjor dhe institucional;
- Konventat ndërkombëtare;
- Vakumet ligjore;
- Sfida për të ardhmen

Kontribut për takimeve bilaterale në kuadër të **kapitullit 24 “Drejtësi, liri dhe siguri”** i cili koordinohet nga Ministria e Brendshme, konkretisht:

Bashkëpunimi ndërgjyqësor për çështjet civile dhe tregtare pika 9.6 “Ndhma Juridike”.

- Të dhëna statistikore ndër vite (2018-2022)

Të dhëna specifike për kategoritë përfituese të ndihmës juridike të garantuar nga shteti;

- Përafrimi i legjislacionit dhe aktet nënligjore;
- Kuadri ligjor dhe institucional;
- Konventat ndërkombëtare;
- Vakumet ligjore;
- Sfida për të ardhmen.

9 Raportime ndërkombëtare:

9.1 Kontribut i përditësuar i DNJF lidhur me zbatimin e Konventës së OKB-së “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave” CEDA”

Kontributi i Drejtorisë lidhet me përmbushjen e rekomandimeve kryesore që rrjedhin nga kjo Konventë për ndihmën juridike falas, konkretisht: Ndhma juridike parësore; Ndhma juridike dytësore; Ndhma juridike ONLINE; Forcimi i kapaciteteve / trajnime; Publikime / promovimi i sistemit të ndihmës juridike (në kuadër të ndërgjegjësimit dhe informimit sa më të gjerë të publikut mbi kushtet / kriteret e përfitimit, ofruesit e shërbimit)

10 Kontribut në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Para-anëtarësimit IPA:

10.1 Kontribut në kuadër të IPA II

Kontrata sektoriale “BE për Reformën në Drejtësi”, synon të kontribuojë në forcimin e shtetit të së drejtës, zbatimit të ligjit dhe të ulë korrupsionin në institucionet qeveritare dhe në gjyqësor. Masat e parashikuara do të kontribuojnë në forcimin e pavarësisë, transparencës, efikasitetit, llogaridhënies dhe besimit të publikut në sistemin e drejtësisë në Shqipëri në përputhje me standardet evropiane, si edhe do të rrisë mbrojtjen e të drejtave të njeriut në sistemin (penitenciar) e vuajtjes së dënimit.

Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas për sa i përket përmbushjes së indikatorit 7 *"Free legal aid services are functional"*, në zbatim të Kontratës Sektoriale *"BE për Reformën në Drejtësi"*, ka përcjellë kontribut si vijon:

- Material përmbledhës mbi ecurinë dhe zhvillimet kryesore të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas përgjatë vitit 2021.
- Në kuadër të hartimit të Raportit hartimit të Raportit Vjetor të Zbatimit të IPA, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas ka përcjelle kontributin mbi përmbushjen e treguesit nr. 7 në zbatim të Kontratës Sektoriale *"BE për Reformën në Drejtësi"* për vitin 2022 në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze.

Gjithashtu, janë një sërë të tjerë dokumentash të tjerë strategjikë të cilët janë në fazat e para të hartimit / konsolidimit të drafteve, për të cilat Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas ka dhënë në mënyrë të vazhdueshme komente dhe sugjerime të ndërlidhura me aksesin në drejtësi, si vijon:

- Strategjia për personat me aftësi të kufizuar;
- Strategjia Kombëtare për Rininë 2022-2029;
- Plani Kombëtar për personat LGBT 2021-2027
- Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021-2026.

Gjithashtu, janë një sërë të tjerë dokumentash të tjerë strategjikë të cilët janë në fazat e para të hartimit / konsolidimit të drafteve, për të cilat Drejtoria ka dhënë në mënyrë të vazhdueshme komente dhe sugjerime të ndërlidhura me aksesin në drejtësi, si vijon:

- Strategjia për personat me aftësi të kufizuar;
- Strategjia Kombëtare për Rininë 2022-2029;
- Strategjia Ndërsektoriale e Menaxhimit të Integruar të Kufirit 2021-2027;
- Plani Kombëtar për personat LGBT 2021-2027
- Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021-2026.

11. Bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare mbështetëse (UNDP/ OSFA/CLE)

11.1 Bashkëpunimi me UNDP

11.1.1 Hapja e qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore

Në mbështetje të Marrëveshjes për zbatimin e projektit, *"Shtrirja e shërbimeve të ndihmës ligjore falas për gratë dhe burrat në Shqipëri"* midis Ministrisë së Drejtësisë, UNDP dhe Agjencisë Austriake për Zhvillim (ADA), është mundësuar lidhja e marrëveshjes së bashkëpunimit me nr. 765/1 prot., dt. 15.02.2022 midis Ministrisë së Drejtësisë dhe UNDP.

- Kjo marrëveshje garanton: Qëndrueshmërinë financiare të qendrave ekzistuese; Kalimin e 2 (dy) qendrave të mbështetura nga UNDP/ADA me buxhet shteti (Qendra Durrës dhe Shkodër); si dhe hapjen me mbështetjen e UNDP/ADA të 4 (katër) qendrave të reja. (Berati dhe Elbasani në 6 mujorin e parë të vitit 2022. Kukësi dhe Korça në 6 mujorin e dytë të vitit 2022).
- Koha e zbatimit të projektit: Shkurt 2022-Janar 2023.
- Shuma e çelur: ~17.000.000 lekë.

11.1.2 Zhvillimi i trajnimeve për ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe dytësore

Me mbështetjen e UNDP është bërë i mundur zhvillimi i trajnimit të detyrueshëm të ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe dytësore (*informacion më i detajuar, gjendet në kreun përkatës*).

11.2 Bashkëpunimi me OSFA

11.2.1 Projekti "Angazhimi pro-aktiv i paraligjorëve në kuadër të rritjes së aksesit të kategorive vulnerabël në shërbimet e ndihmës juridike të garantuar nga shteti" (Korrik 2021-Prill 2022)

Sikurse rezulton edhe nga eksperiencia e shteteve e ndyshme, është e nevojshme që ofrimi i shërbimit të ndihmës juridike parësore të ketë një qasje më proaktive me qëllim identifikimin paraprak të kategorive më në nevojë të cilët hasen me problematika ligjore. Si rrjedhojë, përfshirja e paraligjorëve në ofrimin e ndihmës juridike është një mundësi mjaft e mirë sa i përket identifikimit të komuniteteve në nevojë si dhe vendosjes së një lidhje mes institucioneve shtetërore me komunitetin.

Për këtë arsye, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas në bashkëpunim me fondacionin OSFA ka implementuar projektin: "Angazhimi pro-aktiv i paraligjorëve në kuadër të rritjes së aksesit të kategorive vulnerabël në shërbimet e ndihmës juridike të garantuar nga shteti"

Ky projekt ka për synim rekrutimin e 2 paraligjorëve pranë Qendrës së Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore të cilët kanë ushtruar veprimtarinë e tyre në terren me qëllim evidentimin e komuniteteve (*kategori perfituese të ligjit*) që kanë nevojë për shërbim ligjor falas si dhe zhvillim e aktiviteteve promovuese/dergjegjëse.

- *Objektivi nr. 1: Angazhimi i 2 (dy) paraligjorëve pranë Qendrës së Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Tiranë (përfunduar rekrutimi i paraligjorëve)*
- *Objektivi nr. 2: Trajnimi i paraligjorëve mbi sistemin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas (përfunduar trajnimi i paraligjorëve)*
- *Objektivi nr. 3: Krijimi i një rrjeti me paraligjorët e tjerë të angazhuar pranë Organizatave Jofitimprurëse me fokus bashkëpunimin në referimin e rasteve dhe zgjidhjen e problematikave. (zhvilluar takime të vazhdueshme sipas kalendarit të aktiviteteve të përcaktuara në projekt).*

11.3 Bashkëpunimi me CLE

11.3.1 Mbështetja e Centre For Legal Empowerment sa i përket funksionimit të platformës juristionline.al

Drejtorja e Ndhmës Juridike Falas në bashkëpunim me Fondacionin “Centre for Legal Empowerment”, për të garantuar aksesin e qytetarëve nëpërmjet ndihmës juridike falas, ka mundësuar për të gjithë qytetarët ofrimin e shërbimeve ligjore online përmes **platformës juristionline.al**.

Përmes kësaj platforme çdo qytetar ka mundësi të këshillohet dhe informohet lidhur me aktet normative në fuqi, të drejtat dhe detyrimet e subjekteve të ligjit dhe metodat për ushtrimin e këtyre të drejtave në procesin gjyqësor dhe në atë jashtëgjyqësor, dhënien e ndihmës në hartimin dhe përpilimin e dokumenteve të nevojshme për të vënë në lëvizje administratën shtetërore ose për të kërkuar ndihmë juridike dytësore.

Theksojmë se kjo platformë është një nisëm e organizatës “Centre for Legal Empowerment” me mbështetjen e Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë.

Drejtorja e Ndhmës Juridike Falas nuk disponon të drejta pronësie këtë platformë/serverat por jep kontributin e saj nëpërmjet angazhimit vullnetar të punonjësve të Qendrave të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore në kthimin e përgjigjeve të adresuara në platformë.

11.4 Kërkesë për mbështetje me qëllim forcimin e sistemit të ndihmës juridike falas

Drejtorja e Ndhmës Juridike Falas referuar dhe aktiviteteve të përcaktuara në Strategjinë për Ndhmën Juridike të Garantuar nga Shteti ka patur një kontakt të vazhdueshëm me mbështetës të tjerë potencialë nëpërmjet zhvillimit të takimeve për të shkëmbyer konsiderata dhe mundësi bashkëpunimi.

Përgjatë vitit 2022 janë zhvilluar takime me mbështës potencial si Caritas Shqiptar; OSBE; ADA; GIZ; Expertise France dhe organizata CLE, përmes të cilave është mundësuar:

- Lidhja e marrëveshjes së bashkëpunimit me Caritasin Shqiptar me nr. 1106 prot., datë 09.05.2022;
- Trajnimi i Qendrave të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore mbi legjislacionin e refugjatëve dhe azilkërkuesve me mbështetjen e Caritas Shqiptar në muajin Korrik 2022;
- Lidhja e marrëveshjes së bashkëpunimit me Centre for Legal Empowerment me nr. 1106 prot., datë 09.05.2022;
- Mbështetja e Centre For Legal Empowerment sa i përket funksionimit të platformës juristionline.al;
- Mbështetja e OSBE në kuadër të zhvillimit të një trajnimi me ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike parësore (Klinika/OJF/Qendra) mbi *mënyrën e komunikimit/pritjes së qytetarëve pjesë të kategorive vulberabël me problematika sociale*, për vitin 2023;
- Mbështetja e Expertise France në drejtim të kryerjes së një vizite studimore, shkëmbimi eksperiencash në fushën e ndihmës juridike të garantuar nga shteti.

12. Prokurimet

Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, në strukturën e saj, nuk ka një sektor të posaçëm i cili meret me prokurimin e fondeve. Në mungesë të saj, bazuar në Udhëzimin e Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 5, datë 25.06.2021 *"Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike"*, titullari i DNJF-së, çdo vit ngre një komision për prokurimet i cili ushtron kompetencat e tij gjatë gjithë vitit kalendarik.

Bazuar në nenin 3 të Vendimit Nr.285, datë 19.05.2021 *"Për miratimin e Rregullave të prokurimit publik"* (ndryshuar me Vendimin Nr.710, datë 24.11.2021) si dhe në mbështetje të Udhëzimit Nr.04, datë 18.06.2021 *"Për hartimin e Regjistrin të parashikimeve të procedurave të prokurimit publik dhe Regjistrin të realizimeve të procedurave të prokurimit dhe krijimi i tyre në sistemin e prokurimit elektronik"*, gjatë vitit 2022 Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas për nevojat e saj ka hartuar Regjistrin e Parashikimeve për prokurimin e fondeve në dispozicion, një kopje të të cilit e ka dërguar në Degën e Thesarit Tiranë dhe një kopje në Ministrinë e Drejtësisë.

Në zbatim të ligjit nr.162/2020 *"Për prokurimin publik"*, nenit 56 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.5.2021 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*, (ndryshuar me Vendimin Nr.710, datë 24.11.2021), Udhëzimit të Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 5, datë 25.06.2021 *"Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike"*, Urdhërit të Brendshëm nr. 6 prot., datë 18.01.2022, të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas *"Për krijimin e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël"*, ndryshuar me Urdhërin e Brendshëm nr.187, datë 29.06.2022 *"Për ndryshimin e anëtarëve të komisionit të prokurimit me vlerë të vogël"*, Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël referuar kërkesave për prokurim, konkretisht:

1. Kërkesës nr.292 prot., datë 02.02.2022, me lëndë: Kërkesë për pajisje të ndryshme; (Përfunduar)
2. Kërkesës nr.442 prot., datë 14.02.2022, me lëndë: Kërkesë për blerje materiale pastrimi; (Përfunduar)
3. Kërkesës nr.431/1 prot., datë 01.03.2022, me lëndë: Kërkesë për blerje materiale kancelarie dhe pajisje të ndryshme; (Përfunduar)
4. Kërkesës nr.430 prot., datë 15.02.2022, me lëndë: Kërkesë për blerje bojë printeri/fotokopje; (Përfunduar)
5. Kërkesës nr.52/1 prot., datë 24.02.2022, me lëndë: Kërkesë për blerje pajisje elektronike; (Përfunduar)
6. Kërkesës nr.966/1 prot., datë 27.04.2022, me lëndë: Kërkesë për Blerje bojë printeri/fotokopje për Qendrat e mbështetura nga UNDP; (Përfunduar)
7. Kërkesës nr.1248 prot., datë 02.06.2022, me lëndë: Blerje orendi dhe pajisje për mobilim zyre; (Përfunduar)
8. Kërkesës nr.1720 prot., datë 14.09.2022, me lëndë: Shërbim dezinfektimi (Dezinfektim, Dezisektim, Deratizim). (Përfunduar)
9. Kërkesës nr.1918 prot., datë 19.10.2022, me lëndë: Blerje materiale marketingu (të përfshihet edhe shërbimi i dizenjimit) (Përfunduar)
10. Kërkesës nr.2097/5 prot., datë 24.11.2022, me lëndë: Kërkesë për Blerje materiale kancelarie për Qendrat e mbështetura nga UNDP. (Përfunduar)

Përgatiti gjithë dokumentacionin e nevojshëm në kuadër të realizimit të këtyre procedurave prokurimi, bëri shpalljen e procedurave në faqen elektronike të APP-së www.app.gov.al, realizoi hapjen dhe vlerësimin e ofertave pjesëmarrëse, konfirmoi operatorin fitues si dhe hartoi raportin përmbledhës për secilën prej procedurave.

Gjatë prokurimit të fondeve publike të DNJF-së nuk është administruar asnjë ankesë e operatorëve ekonomik për shkeljen e rregullave ligjore, diskriminim apo trajtim të diferencuar të subjekteve.

Për vitin 2022 për DNJF-në janë akorduar në dispozicion fonde për investime për dy zëra konkretisht, **investim për pajisje elektronike në vlerën 800.000** lekë pa tvsh dhe **investim për mobilje zyre në vlerën 800.000** lekë. Të dy zërat janë prokuruar dhe në këtë mënyrë janë përmbushur nevojat e Drejtorisë për pajisjet e munguara.

Planifikuar në Regjistrin Fillestar të Parashikimeve fond prej 4.740.366 lekë pa TVSH për prokurime nga të cilat janë realizuar të gjitha procedurat e parashikuara në prokurim me një fond prej 2.397.472 lekë pa TVSH. Fondet tregojnë një përdorim eficient pasi janë realizuar të gjitha objektivat e institucionit duke kursyer dhe diferencën e fondit për shkak të ofertave të ulëta të paraqitura nga operatorët ekonomikë.

Për vitin 2022 janë realizuar në total 10 procedura prokurimesh nga 13 procedura të parashikuara në total.

Janë realizuar detyrat e DNJF për plotësimin me bazë materiale. Në procedurat e planifikuara për vitin 2022 nuk janë realizuar vetëm procedura:

-Blerje materiale anticovid (*nuk janë vlerësuar të nevojshme në kushtet kur viti 2022, nuk është konsideruar si një vit pandemik, so rrjedhoje e shfuqizimit të Urdhrit nr. 351 date 29.05.2020, "Për marrjen e masave të vecanta dhe kufizimeve për parandalimin e përhapjes së COVID-19, i ndryshuar*). Si i tillë, përdorimi i këtyre fondeve nuk do të ishte me efektivitet.

-Mirëmbajtje pajisje elektronike (*Nën vlerën 100.00 mijë lekë*). Për arsye të mungesës së një specialisti IT në stafin e DNJF, duke mos bërë të mundur evidentimin e nevojave as nga përfaqësuesit IT të AKSHIT.

13. Të dhëna buxhetore viti 2022

Detajimi i buxhetit për vitin 2022 është mbështetur në Programin Buxhetor Afatmesëm 2022-2024 dhe është realizuar duke mbajtur parasysh objektivat, qëllimin e synuar, përfituesit.

Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, për vitin 2022, ka patur si qëllim të tij ofrimin e ndihmës juridike falas për individët që plotësojnë kushtet, si edhe zbatimin dhe monitorimin e cilësisë së dhënies së ndihmës juridike, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Për realizimin e këtij qëllimi janë përcaktuar objektivat e mëposhtme:

1. Dhënia e ndihmës juridike parësore dhe dytësore për kategoritë përfituese sipas ligjit për ndihmën juridike,
2. Dhënia e ndihmës juridike parësore dhe dytësore për gratë dhe vajzat, pjesë e kategorisë përfituese sipas ligjit për ndihmën juridike.

Tabela e mëposhtme paraqet fondet e akorduara nga buxheti i shtetit dhe donatorëve dhe realizimin e tyre në vlerë dhe përqindje.

Art.	Emertimi	Plani i vitit 2022	Realizimi viti 2022	Realizimi në përqindje i buxhetit
600	Paga	17.400,0	17.124,2	98%
601	Sigurime Shoqërore	2.900,0	2.826,0	97%
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	25.084,0	15.406,6	61,4%
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	516,0	299,0	58%
231	Kapitale te trupezuara	1.300,0	1.181,9	91%
	Shpenzime Korrente	47.200,0	36.837,6	78%
	Te ardhura jashte limiti llogaria 6009999	18.814,3	14.198,2	75,5%
	Te ardhura jashte limiti llogaria 6029999	1.671,8	1.109,4	66,4%
	Shpenzime nga te ardhura jashte limiti	20.486,2	15.307,6	75%
	Totali (korrente + kapitale + Shp nga te ardh.jashte limiti)	67.686,2	52.145,2	77%

Duke iu referuar shifrave për vitin 2022, vihet re një realizim në vlerë prej 36.837.614 lekë të shpenzimeve të fondeve të financuara nga buxheti i shtetit dhe 15.307.571 lekë realizuar nga fondet e dhëna në formë granti për mbulimin e shërbimit juridik parësor për kategoritë përfituese sipas ligjit për ndihmën juridike në qendrat e miratuara nga Ministria e Drejtësisë.(gjithsej 10 qendra me financim nga UNDP dhe 2 punonjës paraligjor nga OSFA).

Me financim nga buxheti i shtetit janë miratuar dhe funksionojnë 4 qendra (Lushnje, Shkodër, Durrës dhe Tiranë).

1. Fondi i pagave dhe sigurimeve shoqërore:

Fondet e celura nga buxheti i shtetit në vlerën totale **20.300.000 lekë (17.400.000 paga dhe 2.900.000 sigurime shoqërore)** nga të cilat realizuar **19.950.135 lekë** ose e shprehur në përqindje në masën **98%**. Realizimi i këtij buxheti i përket fondit të pagave dhe sigurimeve për 22 punonjës nga 25 të miratuar në strukturën organizative të organizimit dhe funksionimit të DNJF.

2. Fondi i shpenzimeve për vendimet gjyqësore:

Gjatë vitit 2022 në total janë shlyer detyrimet financiare me objekt “ndihmën juridike dytësore dhe përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet” për 289 vendime gjyqësore me një kosto prej **9.895.440 lekë**.


3. Fondi për shpenzimet për funksionimin e veprimtarisë së institucionit është realizuar në vlerën **5.511.161 lekë**.

Gjithsej fondi për llogarinë ekonomike 602 (shpenzime operative) është realizuar në masën **61,4%**.

4. Shpenzimet kapitale

Për vitin 2022 Drejtoria e Ndhmës Juridike ka patur buxhet të çelur për investime në vlerën 1.300.000. lekë, prej të cilave janë **realizuar 1.181.878 lekë (91%)**.


➤ **Realizimi i fondeve buxhetore sipas grafikut:**



Pjesë e buxhetit të vitit 2022 janë edhe fondet e akorduara nga dy organizatat ndërkombëtare UNDP dhe OSFA për mbulimin e shërbimit juridik parësor për kategoritë përfituese sipas ligjit për ndihmën juridike në qendrat e miratuara nga Ministria e Drejtësisë.(gjithsej 10 qendra me financim nga UNDP dhe 2 punonjës paraligjor nga OSFA). Fondet e akorduara gjatë këtij viti janë në vlerën **20.486.156 lekë**, me fokus pagesën e pagave dhe sigurimeve shoqërore për 10 qendra me nga 2 punonjës, si edhe 2 punonjës paraligjor. Ky fond është realizuar në masën 75% në vitin 2022 dhe fondet e mbetura janë mbartuar për përdorim në vitin 2023 në koherencë të zbatimit të akt-marrëveshjeve dhe kontratave me donatorët.

Më poshtë realizimi në formë grafiku i fondeve të akorduar nga donator.

➤ **Realizimi i fondeve nga organizatat në formën e granteve sipas grafikut:**



DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

Arritjet e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas për vitin 2022

Vështrim krahasimor me vitin 2021

	Arritjet për çdo objektiv	2021	2022
1	Numri i ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike parësore	<p>33 ofrues të shërbimit të ndihmës juridike parësore</p> <p><i>(10 Qendra, 12 OJF; 11 Klinika Ligji pranë Universiteteve)</i></p>	<p>41 ofrues të shërbimit të ndihmës juridike parësore</p> <p><i>(14 Qendra, 15 OJF; 12 Klinika Ligji pranë Universiteteve)</i></p>
2	Ofrimi i ndihmës juridike falas nga qendrat të shërbimit të ndihmës juridike parësore	<p>10 Qendra të shërbimit të ndihmës juridike parësore <i>(Tiranë, Durrës, Lushnje, Fier, Vlorë, Pogradec, Gjirokastër, Lezhë, Shkodër dhe Dibër)</i></p> <p>2 Qendra me buxhet shteti në Tiranë dhe Lushnje</p> <p>8 Qendra me mbështetjen e PNUD <i>(Për vitin 2021 janë hapur 3 qendrat e reja në Vlorë, Dibër dhe Fier)</i></p>	<p>14 Qendra të shërbimit të ndihmës juridike parësore <i>(Tiranë, Durrës, Elbasan, Lushnje, Berat, Fier, Vlorë, Pogradec, Gjirokastër, Lezhë, Shkodër, Dibër, Kukës dhe Korçë)</i></p> <p>4 Qendra me buxhet shteti. Kaluar qendra Shkodër dhe Durrës me buxhet shteti. <i>(Tiranë, Lushnje, Shkodër dhe Durrës)</i></p> <p>10 Qendra me mbështetjen e PNUD <i>(Për vitin 2022 janë hapur 4 qendrat e reja në Berat, Elbasan, Korçë dhe Kukës)</i></p> <p>Në vijim të mbylljes së sporteleve të ADISA, më dt. 16.05.2022, Drejtori i Përgjithshëm, në bashkëpunim me PNUD, zhvilloi një takim me Kryetaren e Këshillit të Qarkut Fier gjatë të cilës u dakordësua Vendosja në dispozicion e (zyrës) në katin e 1 (parë) të Këshillit të Qarkut Fier. Qendra Fier ushtron funksionin pranë Këshillit të Qarkut Fier që prej muajit Shtator 2022.</p> <p>U mundësua lidhja e Marrëveshjes së Bashkëpunimit me Bashkinë Gjirokastër me nr 1105/7 prot., datë 09.06.2022, "Për vendosjen në dispozicion të një ambienti pa kundërshpërblim në godinën e Pallatit të Sportit Gjirokastër (godinë nën administrimin e Bashkisë Gjirokastër).</p> <p>Qendra Gjirokastër ushtron funksionin pranë Pallatit të Sportit Gjirokastër që prej muajit Korrik 2022.</p>

3	Ofrimi i ndihmës juridike falas nga Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve	11 marrëveshje bashkëpunimi të lidhura me Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve Lidhet marrëveshja e bashkëpunimit me Klinikën e Ligjit pranë <i>Universitetit Marin Barleti</i> dhe <i>Universitetit Luarasi</i>	12 marrëveshje bashkëpunimi të lidhura me Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve Lidhet marrëveshja e bashkëpunimit me Klinikën e Ligjit pranë <i>Universitetit Epoka</i>
4	Ofrimi i ndihmës juridike falas nga organizatat jofitimprurëse	12 organizata jofitimprurëse të autorizuara nga Ministri i Drejtësisë në muajin Shtator 2020 (autorizim 2 vjeçar sipas VKM nr. 55/2019).	15 organizata jofitimprurëse të autorizuara nga Ministri i Drejtësisë në muajin Shtator 2022 (3 organizata më shumë se në autorizimi Shtator 2020 të specializuara në fushën e viktimave të dhunës në familje, të miturve, refugjatëve etj.);
5	Ofrimi i ndihmës juridike dytësore nga avokatët	124 avokatë kanë lidhur kontratën për ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike dytësore për vitin 2021.	157 avokatë aktivë kanë lidhur kontratën për ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike dytësore për vitin 2022.
6	Vlerësimi i cilësisë së ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes	Realizuar monitorimi fillestar dhe i vazhdueshëm i 10 qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore (<i>Tiranë, Durrës, Fier, Lezhë, Pogradec, Vlorë, Shkodër, Lushnje, Gjirokastër, Fier</i>) si dhe monitorimi fillestar dhe i vazhdueshëm për avokatët e ndihmës juridike dytësore;	Realizuar monitorimi fillestar dhe i vazhdueshëm i 12 qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore (<i>Tiranë, Durrës, Fier, Lezhë, Pogradec, Vlorë, Shkodër, Lushnje, Gjirokastër, Fier, Berat, Elbasan</i>) si dhe monitorimi fillestar dhe i vazhdueshëm për avokatët e ndihmës juridike dytësore; Në proces: Zhvillimi i monitorimit fillestar për Qendrën e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Kukës dhe Korçë.
7	Zhvillimi i takimeve/aktiviteteve të përbashkëta mes ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike/përfaqësuesve të institucioneve në nivel vendor/qendror dhe institucioneve të pavarura	Zhvilluar 125 takime/aktivitete ndërgjegjësuere të përbashkëta mes ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike/përfaqësuesve të institucioneve në nivel vendor/qendror dhe institucioneve të pavarura Zhvilluar 5 intervista televizive në televizionet lokale nga Qendrat e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore;	Zhvilluar 286 takime/aktivitete ndërgjegjësuere të përbashkëta mes ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike/përfaqësuesve të institucioneve në nivel vendor/qendror dhe institucioneve të pavarura për vitin 2022. Zhvilluar 1 intervistë në radio e Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtërisë së Ndihmës Juridike Falas. Zhvilluar 10 intervista televizive në televizionet lokale nga Qendrat e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore.

8	<p>Bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare mbështetëse</p>	<p>Bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare mbështetëse:</p> <p>UNDP/ADA (mbështetja për Qendrat e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore);</p> <p>OSFA/CLE (mbështetja për angazhimin e paraligjorëve për zhvillimin e fushatave informuese në terren);</p> <p>OSCE (mbështetja për zhvillimin e konferencës studentore: "Ndihma juridike e garantuar nga Shteti");</p> <p>Euralius (Publikimi i Manualit të Ligjit nr.111/2017, dhe akteve nënligjore të miratuara në zbatim të tij).</p>	<p>Vijuar bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare mbështetëse:</p> <p>UNDP/ADA (mbështetja për Qendrat e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore);</p> <p>OSFA/CLE (mbështetja për angazhimin e paraligjorëve për zhvillimin e fushatave informuese në terren);</p> <p>Caritas Shqiptar (mbështetja për zhvillimin e trajnimit të punonjësve që Qendrave);</p> <p>Expertise France Group ATD (Barazia gjinore në aksesin në mundësitë ekonomike).</p> <p>Pjesëmarrje e DNJF në kuadër të zbatimit të projektit JUSTAL "Asistencë teknike për mbështetjen e zbatimit të strategjisë ndërsektoriale të Drejtësisë në Shqipëri", financuar nga Bashkimi Evropian (IPA II), për periudhën kohore 15 Qershor 2022- 14 Qershor 2024.</p>
9	<p>Nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet në nivel qendror, vendor institucionet e pavarura dhe gjykatat, në kuadër të referimit të rasteve dhe ndërgjegjësimin</p>	<p>Lidhur 9 marrëveshje bashkëpunimi (me Organizatën Drejtësi Sociale; Shoqatën "Refleksione"; Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Shkodër; Shoqatën e Invalidëve të Punës; Shoqatën "Shqipëria", Vlorë; Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Patos; Shoqatën "Shtëpi Shprese"; Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Berat; Organizatën Jofitimprurëse MDG Berat)</p>	<p>Lidhur 17 marrëveshje bashkëpunimi(me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi; Bashkinë Berat; Bashkinë Gjirokastrë; Bashkinë Kukës; Bashkinë Korçë; Caritasin Shqiptar; Universitetin Epoka; Këshillin e Qarkut Fier; Gjykatën e Rr. Gj. Elbasan; Gjykatën e Rr. Gj.Durrës; Gjykatën e Rr. Gj.Shkodër; Drejtorinë e Kujdesit Social Bashkia Lezhë; Organizatën "Vatra"; ISSH Gjirokastrë; Qendrën Evropiane; Qendrën për Fuqizimin Ligjor; Fondacionin "Joscelyn");</p>
10	<p>Trajnimi i ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe dytësore</p>	<p>Përfunduar trajnimi i detyrueshëm të ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe dytësore</p>	<p>Zhvillimi i trajnimeve për 234 studentë të angazhuar pranë Klinikave të Ligjit si dhe zhvillimi praktikave pranë DNJF, Qendrës Tiranë, Vlorë dhe Shkodër për 37 studentë.</p> <p>Përfunduar trajnimi i detyrueshëm i 14 ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike parësore të cilët nuk i ishin nënshtruar trajnimit në vitin 2021.</p>

11	Raste të trajtuara, ndihma juridike parësore	8153 raste të trajtuara nga Qendrat e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore, Organizatat Jofitimprurëse të Autorizuara, Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve, platforma juristonline dhe numri i gjelbër 08001010.	7616 raste të trajtuara nga Qendrat e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore, Organizatat Jofitimprurëse të Autorizuara, Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve, platforma juristonline dhe numri i gjelbër 08001010.
12	Raste të trajtuara, ndihma juridike dytësore	841 vendime me objekt përfitimin e ndihmës juridike dytësore/ përjashtimin nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore.	1030 vendime gjyqësore me objekt përfitimin e ndihmës juridike dytësore/ përjashtimin nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore.
13	Realizimi Buxhetor: Fonde Buxhetore të akorduara: Fonde Jobuxhetore nga organizata :	29.702.483 lekë 66.200.000 lekë 15.253.893 lekë	36.837.614 lekë 47.200.000 lekë 20.486.157 lekë
14	Numri i vendimeve gjyqësore të likujduara nga DNJF	Numri i vendimeve gjyqësore të likujduara me objekt ndihmën juridike dytësore gjatë vitit 2021 143 është vendime. Ndhmë juridike dytësore (pagesa avokatësh, ekspertësh dhe tarifa gjyqësore) me vlerë totale prej 5,188,929 lekë	Numri i vendimeve gjyqësore të likujduara me objekt ndihmën juridike dytësore për periudhën 2022 është 289 vendime. Ndhmë juridike dytësore (pagesa avokatësh, ekspertësh dhe tarifa gjyqësore) me vlerë totale prej 9.895.440 lekë.

DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS
RAPORTIM MBI ZBATIMIN E PLANIT TË PUNËS
JANAR-DHJETOR 2023

Plani i punës Janar-Dhjetor 2023, përmbledh detyrimet funksionale dhe obligimet që rrjedhin nga Ligji Nr. 111/2017, politikat dhe prioritetet e përcaktuara nga Ministri i Drejtësisë si dhe dokumentat strategjikë në të cilat DNJF është e përfshirë.

Plani i punës Janar-Dhjetor 2023, është plani i katërt i miratuar që nga fillimi i funksionimit të DNJF. Ky dokument është kontribut dhe ka për objekt veprimtarinë e të tre Drejtorive përbërëse të DNJF. Ky plan është një dokument pune i cili shërben si udhëheqës në realizimin e objektivave institucionale përmes përcaktimit të masave dhe aktiviteteve konkrete.

Plani i punës Janar-Dhjetor 2023, përmbledh detyrimet funksionale, përpilimin dhe zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 për *"Zbatimin e Sistemit Buxhetor në RSH"*, ndryshuar me ligjin nr. 84/2022, *"Për buxhetin e vitit 2023"*, duke synuar zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, strukturën, parimet dhe bazat e procesit buxhetor, marrëdhëniet financiare si dhe përgjegjësitë për zbatimin e legjislacionit buxhetor në tërësi.

Plani i punës Janar-Dhjetor 2023, parashikon **15 objektiva të strukturuar** si vijon:

- Garantimi i funksionimit të sistemit të ndihmës juridike parësore;
- Garantimi i funksionimit të sistemit të ndihmës juridike dytësore;
- Monitorimi i shërbimit të ndihmës juridike parësore/dytësore;
- Ndërveprimi me donatorët dhe institucionet e përfshira në sistemin e ndihmës juridike falas;
- Dhënia e kontributit të DNJF në kuadër të dokumentave strategjike dhe procesit të integritetit evropian;
- Informimi dhe promovimi mbi sistemin e ndihmës juridike;
- Raportime mbi sistemin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti;
- Menaxhimi dhe planifikimi financiar i sistemit të ndihmës juridike;
- Rialokimi dhe detajimi i fondeve të buxhetit vjetor;
- Hartimi i raporteve financiare në kuadër të grateve/projekteve në bashkëpunim me Organizatat Ndërkombëtare;
- Mirëadministrimi i Burimeve Njerëzore;
- Prokurimi i fondeve publike;
- Hartimi i regjistrit të riskut, formularet e vetëvlerësimit si dhe Plani i veprimit për Menaxhimin financiar dhe Kontrollin;
- Analiza e buxhetit si dhe mbyllja e pasqyrave financiare për vitin ushtrimor 2022;
- Miratimi i strukturës së drejtorisë së ndihmës juridike falas

Plani i Punës Janar-Dhjetor 2023
Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas

OBJEKTIVI I: GARANTIMI I FUNKSIONIMIT TË SISTEMIT TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE					
Nr.	Masat / proceset e planifikuara	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Institucioni/ Dr. Përgjegjëse	Afate / komente	Realizimi i masës
1.1	Lidhja e marrëveshjes së re të bashkëpunimit midis Ministrisë së Drejtësisë dhe UNDP (Shkurt 2023-Janar 2024)	Ndërmarrja e procedurave në kuadër të lidhjes së marrëveshjes së re të bashkëpunimit	Drejtoria e Zbatimit të Politikave dhe Administrimit të Ndhmës Parësore.	Shkurt 2023	
1.2	Administrimi i qendrave aktuale të ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike parësore	Mbarëvajtja e veprimtarisë së qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore përmes: <ul style="list-style-type: none"> - Komunikimit ditor me punonjësit e qendrave; - Administrimit të të dhënave të shërbimit të ofruar; - Adresimit dhe përcjelljes së çdo problematike të punonjësve të qendrave; - Zhvillimit të aktiviteteve të përbashkëta në kuadër të promovimit të qendrave; - Mirëfunksionimit të qendrave përmes pajisjeve me mjetet e nevojshme logjistike. 		Janar - Dhjetor 2023	
1.3	Kalimi nën administrim të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas të 2 nga 10 qendrat e hapura me mbështetjen e UNDP	Ndërmarrja e procedurave në kuadër të kalimit nën administrim të Qendrave të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore me performancë më të lartë.		Janar - Qershor 2023	

1.4	Hapja e 6 qendrave të reja të ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike parësore me buxhet shteti, pas miratimit të strukturës së re të DNJF	<p>Ndërmarrja e procedurave në kuadër të hapjes së 6 të Qendrave të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore përmes:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Komunikimit dhe lidhjes së Marrëveshjeve të Bashkëpunimit me Gjykatat në kuadër të vendosjes në dispozicion të ambienteve pa kundërshpërblim për funksionimin e Qendrave të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore; - Hapjes së thirrjes dhe marrjes pjesë në procedurat e rekrutimit të punonjësve të rinj - Pajisjes së qendrave të reja me mjetet e nevojshme logjistike dhe të vizibilitetit; - Trajnimit të punonjësve të rinj mbi kuadrin ligjor në fushën e ndihmës juridike dhe mënyrën e raportimit pranë DNJF 		Qershor-Dhjetor 2023	
1.5	Ofrimi i ndihmës juridike parësore nga Organizatet jofitimprurëse të autorizuara	<ul style="list-style-type: none"> - Komunikimi me përfaqësuesit e organizatave jofitimprurëse të autorizuara; - Administrimi i të dhënave të shërbimit të ofruar; - Zhvillimi i aktiviteteve të përbashkëta në kuadër të promovimit 	Drejtoria e Zbatimit të Politikave dhe Administrimit të Ndhmës Parësore.	Janar-Dhjetor 2023	
1.6	Hapja e thirrjes për financimin e organizatave jofitimprurëse të autorizuara nga Ministri i Drejtësisë	<ul style="list-style-type: none"> - Zhvillimi i takimeve me OJF që kanë shprehur interes për aplikim në kuadër të sqarimit të procedurës së aplikimit dhe vlerësimit sipas metodologjisë së financimit; - Marrja pjesë në komisionin e vlerësimit dhe ankimit për financimin e OJF-ve - Ndërmarrja e procedurave për lidhjen e kontratave me Organizatat e shpallura fituese 	DNJF	Janar-Maj 2023	

1.7	Ofrimi i ndihmës juridike parësore nga Klinikat e Ligjit	Ndërveprimi aktiv mes DNJF dhe Klinikave të Ligjit me të cilat kemi lidhur marrëveshje bashkëpunimit përmes: <ul style="list-style-type: none"> - Trajnimit mbi ndihmën juridike për studentët e angazhuar pranë Klinikave të Ligjit; - Praktikave të punës për studentët e angazhuar pranë Klinikave të Ligjit; - Zhvillimit të aktiviteve të përbashkëta ndërgjegjësuere/informuese 	Drejtoria e Zbatimit të Politikave dhe Administrimit të Ndhmës Parësore.	Janar-Dhjetor 2023	
1.8	Administrimi i plotë i të dhënave mbi shërbimin e ndihmës juridike parësore	<ul style="list-style-type: none"> - Mbledhja dhe sistematizimi i të dhënave mbi ndihmën juridike parësore; - Plotësimi i regjistrit të kërkesave dhe vetëdeklarimeve për ndihmën juridike parësore - Hartimi dhe publikimi në faqen zyrtare të analizës statistikore mbi ndihmën juridike parësore (<i>analizë që hartohet çdo muaj</i>) 	Drejtoria e Zbatimit të Politikave dhe Administrimit të Ndhmës Parësore.	Janar-Dhjetor 2023	

OBJEKTIVI 2: GARANTIMI I FUNKSIONIMIT TË SISTEMIT TË NDIHMËS JURIDIKE DYTËSORE

Nr.	Masat / proceset e planifikuara	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Institucioni/ Dr. Përgjegjës	Afate / komente	
2.1	Sigurimi i shërbimit të avokatëve	- Lidhja e kontratës me avokatët për vitin 2023 si dhe publikimi i listës	Drejtoria e Mbikëqyrjes	Janar-Mars 2023	
2.2	Administrimi i të dhënave mbi shërbimin e ndihmës juridike dytësore	<ul style="list-style-type: none"> - Mbledhja dhe sistematizimi i të dhënave mbi numrin e vendimeve gjyqësore me objekt ndihmën juridike dytësore; - Plotësimi i regjistrit të kërkesave dhe vetëdeklarimeve për ndihmën juridike dytësore për përjashtimin nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore; - Hartimi dhe publikimi në faqen zyrtare të analizës statistikore mbi ndihmën juridike dytësore (<i>analizë që hartohet çdo muaj</i>) 	Drejtoria e Mbikëqyrjes	Janar-Dhjetor 2023	

2.3	Ndjekja e vendimeve gjyqësore me objekt përfitimin e ndihmës juridike dytësore	<ul style="list-style-type: none"> - Komunikimi me Dhomat Vendore të Avokatisë në kuadër të caktimit të avokatit që do të ofrojë shërbimin e ndihmës juridike dytësore; - Ankimimi i vendimeve gjyqësore me objekt përfitimin e ndihmës juridike dytësore dhe/ose përjashtim nga shpenzimet / tarifat gjyqësore. 	Drejtoria e Mbikëqyrjes	Janar-Dhjetor 2023	
-----	---	--	--------------------------------	--------------------	--

OBJEKTIVI 3: MONITORIMI I SHËRBIMIT TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE/DYTËSORE

Nr.	Masat / proceset e planifikuara	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Institucioni/ Dr. Përgjegjës	Afate / komente	
3.1	Monitorimi i shërbimit të ofruar nga Qendrat e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore	Hartimi dhe miratimi i kalendarit të monitorimeve	Drejtoria e Mbikëqyrjes	Janar 2023	
Kryerja e monitorimeve tremujore për qendrat e ndihmës juridike parësore		Janar-Mars 2023 Prill-Qershor 2023 Korrik - Shtator 2023 Shtator-Dhjetor 2023			
Monitorimi dhe kontaktimi i vazhdueshëm me qendrat; dërgimi i raporteve mujore narrative mbi ecurinë e punës ²		Janar-Dhjetor 2023			
Hartimi i raporteve të monitorimit / Vlerësimi i performancës	Janar-Mars 2023 Prill-Qershor 2023 Korrik-Shtator 2023 Shtator-Dhjetor 2023				

² Sipas **formatit narrativ të hartuar** mbi bazën e të cilit qendrat kanë vijuar të dërgojnë të dhënat mbi ecurinë e punës dhe veprimtarinë mujore.

3.2	Monitorimi i shërbimit të ofruar nga Organizatat Jofitimprurëse të Autorizuara të cilat përfitojnë financim nga buxheti i shtetit	Hartimi dhe miratimi i kalendarit të monitorimeve	Drejtoria e Mbikëqyrjes	Maj 2023	
		Kryerja e monitorimeve katër mujore për organizatat		Maj-Gusht 2023	
		Hartimi i raporteve të monitorimit / Vlerësimi i performancës		Shtator-Dhjetor 2023	
3.3	Monitorimi i shërbimit të ofruar nga Avokatët e ndihmës juridike dytësore	Hartimi dhe miratimi i kalendarit të monitorimeve	Drejtoria e Mbikëqyrjes	Janar 2023	
		Kryerja e monitorimit fillestar për avokatët e rinj të ndihmës juridike dytësore		Janar-Qershor 2023	
		Kryerja e monitorimit të vazhdueshëm për çdo avokat të ndihmës juridike dytësore		Janar-Dhjetor 2023	
		Hartimi i raporteve të monitorimit / Vlerësimi i performancës		Janar-Dhjetor 2023	
		Hartimi i raporteve të mbikëqyrjes dhe përcjellja e rekomandimeve përkatëse		Janar-Dhjetor 2023	

OBJEKTIVI 4: NDËRVEPRIMI ME DONATORËT DHE INSTITUCIONET E PËRFSHIRA NË SISTEMIN E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

Nr.	Masat / proceset e planifikuara	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Institucioni/ Dr. Përgjegjës	Afate / komente	Realizimi i masës
4.1	Ndërveprimi me UNDP në kuadër të projekteve të përbashkëta	<p>Raportim narrativ dhe financiar çdo katër muajor</p> <p>Hartimi i faceform çdo katër muajor</p> <p>Rakordimi me degën e thesarit për të fondet e UNDP</p> <p>Ndërmarrja e masave të nevojshme për plotësimin e nevojave logjistike të qendrave të hapura me mbështetjen e UNDP;</p> <p>Ndërveprimi në kuadër të promovimit të qendrave përmes publikimit të spoteve informuese; materialeve të vizibilitetit etj.</p> <p>Ndëveprimi lidhur me aktivitete të përbashkëta me fokus krijimin e netëorkut ndërmjet ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe institucioneve të pushtetit vendor/ qendror.</p>	<p>Drejtoria e Zbatimit të Politikave</p> <p>Drejtoria e Financës</p> <p>UNDP</p>	<p>Shkurt-Maj 2023 Qershor-Shtator 2023 Tetor-Janar 2023</p> <p>Shkurt-Maj 2023 Qershor-Shtator 2023 Tetor-Janar 2023</p> <p>Janar-Dhjetor 2023</p> <p>Janar-Dhjetor 2023</p> <p>Janar-Dhjetor 2023</p> <p>Janar-Dhjetor 2023</p>	
4.2	Ndjekja e proceseve të punës me donatorë të ndryshëm si OSCE, Agjencia Franceze për Zhvillim, JUSTAL etj.	<ul style="list-style-type: none"> - Evidentimi i nevojave për mbështetje; - Zhvillimi i takimeve në kuadër të bashkëpunimit; - Ndërmarrja e procedurave të bashkëpunimit në rast dakordësie 	<p>DNJF</p> <p>UNDP</p>	<p>Janar-Dhjetor 2023</p> <p><i>Në varësi të projekteve me donatorët</i></p>	

OBJEKTIVI 5: DHËNIA E KONTRIBUTIT DHE RAPORTIMI I DNJF NË KUADËR TË PROCESIT TË INTEGRIMIT EVROPIAN/STRATEGJIVE

Nr.	Masat / proceset e planifikuara	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Institucioni/ Dr. Përgjegjës	Afate / komente	Realizimi i masës
5.1	Raportime në kuadër të procesit të Integritimit Evropian dhe Konventave Ndërkombëtare/Strategjive	<ul style="list-style-type: none"> - Angazhim i DNJF në kuadër të Strategjisë për Edukimin Ligjor të Publikut (SELP). - Angazhim i DNJF në kuadër të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë (SND) - Angazhim i DNJF në kuadër të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2020 (SNKK) - Angazhim i DNJF në kuadër të Strategjisë së Drejtësisë për të Miturit (SDM) - Kontribut i DNJF në kuadër të angazhimit në Planin e Veprimit për Partneritet dhe Qeverisje të Hapur (OGP) - Angazhimet e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas në kuadër të procesit të Integritimit Evropian dhe Raportimeve Ndërkombëtare - Kontribut në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Para-anëtarësimit IPA 	<p>Drejtoria e Zbatimit të Politikave</p> <p>Drejtoria e Financës</p>	Janar -Dhjetor 2023	

OBJEKTIVI 6: PROMOVIMI I SISTEMIT TË NDIHMËS JURIDIKE

Nr.	Masat / proceset e planifikuara	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Institucioni/ Dr. Përgjegjës	Afate / komente	Realizimi i masës
6.1	Përgatitja dhe ndjekja e publikimeve të DNJF në faqen zyrtare dhe në rrjetet sociale të Facebook, instagram	Ndjekje e procedurave të nevojshme me qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve.	DNJF	Janar-Dhjetor 2023	

6.2	Përditësimi i faqes ëeb të DNJF	Përditësimi dhe publikimi i të dhënave më të fundit sipas rubrikave të mirëpërcaktuara.	DNJF	Janar-Dhjetor 2023 <i>Në bazë të mundësisë për aksesimin e faqes si pasojë e mos-funksionimit pas sulmit kibernetik të muajit Korrik 2022</i>	
6.3	Zhvillimi i takimeve promovuese/sensibilizuese/ edukimit ligjor të publikut	<ul style="list-style-type: none"> - Zhvillimi i fushatave të ndërgjegjësimit; - Zhvillimi i ëebinareve me fokus promovimin/informimin mbi sistemin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti - Zhvillimi i sesioneve informuese mbi aksesin në drejtësi përmes ndihmës juridike të garantuar nga shteti. 	DNJF Ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike parësore	Kalendari aktiviteteteve Janar 2023 Shkurt 2023 Mars 2023 Prill 2023 Maj 2023 Qershor 2023 Korrik 2023 Gusht 2023 Shtator 2023 Tetor 2023 Nëntor 2023 Dhjetor 2023	
6.4	Hartimi dhe publikimi i materialeve të vizibilitetit	- Hartimi i manualeve të thjeshtëzuara me fokus specifik kategoritë e veçanta përfituese të ligjit.	DNJF	Janar-Dhjetor 2023	

OBJEKTIVI 7: RAPORTIME MBI SISTEMIN E NDIHMËS JURIDIKE TË GARANTUAR NGA SHTETI

Nr.	Masat / proceset e planifikuara	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Institucioni/ Dr. Përgjegjës	Afate / komente	Realizimi i masës
7.1	Përgatitja e raportimeve drejtuar Ministrit të Drejtësisë mbi sistemin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti ³	<ul style="list-style-type: none"> - Hartimi i raportimeve mujore; 3 mujore; 6 mujore dhe vjetore drejtuar Ministrit të Drejtësisë; - Hartimi i raportimeve të tjera drejtuar Ministrit të Drejtësisë në varësi të kërkesave 	DNJF	Janar-Mars 2023 Prill-Qershor 2023 Korrik-Shtator 2023 Tetor-Dhjetor 2023	
7.2	Trajtimi i shkresave nga institucione të ndryshme në kuadër të raportimit mbi ecurinë dhe progresin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti	Dhënia e informacionit mbi ecurinë dhe zhvillimet e sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti lidhur me kërkesat për informacion	DNJF	Janar-Dhjetor 2023	

OBJEKTIVI 8: MENAXHIMI DHE PLANIFIKIMI FINANCIAR I SISTEMIT TË NDIHMËS JURIDIKE

Nr.	Masat / proceset e planifikuara	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Institucioni/ Dr. Përgjegjës	Afate / komente	Realizimi i masës
8.1	Vlerësimi i kostove dhe planifikimi i shpenzimeve të lidhura me dhënien e ndihmës juridike	Ndjekja, analizimi dhe planifikimi i shpenzimeve financiare mbi sistemin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti.	Dr. Financave	Janar 2023	
8.2	Menaxhimi i fondeve buxhetore për dhënien e ndihmës juridike	Menaaxhimi i fondeve buxhetore të DNJF dhe hartimi i raportimeve financiare	Dr. Financave	Janar 2023	

3 Sipas përcaktimeve të Ligjit nr.111/2017.

OBJEKTIVI 9 : RIALOKIMI DHE DETAJIMIN I FONDEVE TË BUXHETIT VJETOR RAPORTIME;

Nr.	Masat / proceset e planifikuara	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Institucioni/Dr. Përgjegjës	Afate / komente	Realizimi i masës
9	Detajimi i fondëve të Buxhetit për vitin 2023	Rialokimi i fondëve të përdorura me financim nga donatorët sipas strukturave buxhetore si dhe sipas nevojave të institucionit	Drejtoria e Financës	Janar-Nëntor 2023	
		Pasqyrimi në regjistrin e parashikimit të prokurimeve publike dhe shpallja në faqen zyrtare të APP dhe Institucionit të ndryshimeve	Komisioni i Prokurimit	Janar 2023	
		Realizimi i likuidimit të detyrimeve të prapambetura me prioritet	Drejtoria e Financës	Janar-Dhjetor 2023	

OBJEKTIVI 10: HARTIMI I PAGESAVE TË PUNONJËSVE TË DNJF NGA STRUKTURAT E BUXHETIT TË SHETIT DHE NGA ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE

Nr.	Masat / proceset e planifikuara	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Institucioni/Dr. Përgjegjës	Afate / komente	Realizimi i masës
10.1	Hartimi i dokumentacionit financiar, për pagat sigurimet dhe shpenzimet	Hartimi i pagesave të pagave të punonjësve të NDJF si dhe punonjësve të qendrave të sponsorizuara nga OJF	Drejtoria e Financës	Janar-Dhjetor 2023	
		Hartimi i Urdhër Shpenzimeve për shpenzimet financiare të artikujve 600 dhe 601		Janar-Dhjetor 2023	
		Deklarimi i sigurimeve shoqërore shëndetsore dhe tatimit mbi të ardhurat		Janar-Dhjetor 2023	
		Pasqyrimi në sistemin HRMIS të pagave të punonjësve		Janar-Dhjetor 2023	
		Hartimi i listëprezencës së punonjësve		Janar-Dhjetor 2023	

10.2	Urdhër Pagesat	Gjenerimi nga sistemi HRMIS i Urdhër Shpenzimeve	Drejtoria e Financës	Janar-Dhjetor 2023	
		Transfertat bankare sipas Bankave të nivelit të dytë			
		Pasqyrimi i shtesave, ndalesave apo cdo vendim gjyqësor			
		Sistemi AFMIS, paraqitja e dokumentacionit justifikues të shpenzimit dhe ngarkimi në sistem			
10.3	Hartimi i raporteve përmblidhëse të monitorimit	Raport përmblidhës monitorimi për shërbimin e ndihmës juridike parësore;	Drejtoria e Mbikëqyrjes	Janar-Dhjetor 2023	
10.4	Kryerja e pagesave për ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike	Raport përmblidhës monitorimi për shërbimin e ndihmës juridike dytësore.	Drejtoria e Financës	Janar-Dhjetor 2023	

OBJEKTIVI 11: MIRËADMINISTRIMI I BURIMEVE NJERËZORE DHE REKRUTIMI I PUNONJËSVE

Nr.	Masat / proceset e planifikuara	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Institucioni/ Dr. Përgjegjës	Afate / komente	Realizimi i masës
11.1	Evidentimi i nevojave për kualifikimin e punonjësve	Evidentimi i kualifikimeve të punonjësve Hartimi i planit vjetor të zhvillimit profesional të BNJ	Drejtoria e Financës ASPA	Janar-Qershor 2023	

11.2	Vendet vakante	Evidentimi dhe raportimi i vendeve vakante në zbatim të strukturës së miratuar për institucionin	DAP Drejtoria e Financës Burimet Njerëzore	Janar-Dhjetor 2023	
		Shpallja e vendeve vakante ne Sitemin HRMIS për punonjësit me Status të Nëpunësit Civil		Janar-Dhjetor 2023	
		Percaktimi i përshkrimit të punës dhe përcaktimi i kriterëve për kualifikim në procedurën e rekrutimit të punonjësve		Janar-Dhjetor 2023	
		Shpallja në faqen Zyrtare të DNJF për vendet vakante, Ngritja e Grupit të punës për pranimin ose skualifikimin e kandidatëve		Janar-Dhjetor 2023	

OBJEKTIVI 12: PROKURIMI I FONDEVE PUBLIKE

Nr.	Masat / proceset e planifikuara	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Institucioni/ Dr. Përgjegjës	Afate / komente	
12.1	Evidentimi i nevojave të institucionit për bazë materiale, shërbime etj	Kërkesat e Drejtorive për t'u pajisur me Bazë Materiale dhe shërbime në funksion të veprimtarisë së Institucionit	Drejtoritë	Janar 2023	
12.2	Prokurimi i Fondeve	Ngritja e Komisionit të Prokurimit për Blerje me Vlerë të Vogël	Drejtori i Përgjithshëm	Janar 2023	
		Hartimi i Ftesës për Ofertë	Drejtoria e Financës Komisioni i Prokurimit	Janar-Dhjetor 2023	
		Specifikimet teknike të mallrave dhe shërbimeve		Janar-Dhjetor 2023	
		Dokumentimi në sistemin e Prokurimit Publik		Janar-Dhjetor 2023	
Realizimi i kontratës					

OBJEKTIVI 13: HARTIMI I REGJISTRIT TE RISKUT, FORMULARET E VETËVLERËSIMIT SI DHE PLANI I VEPRIMIT PËR MENAXHIMIN FINANCIAR DHE KONTROLLIN					
Nr.	Masat / proceset e planifikuara	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Institucioni/ Dr. Përgjegjës	Afate / komente	Realizimi i masës
13.1	Hartimi i regjistrit të riskut	Ngritja e grupit të punës për hartimin e regjistrit të riskut	Grupi i punës Drejtoria e Financës	Janar 2023	
13.2	Hartimi i formularit të vetëvlerësimit për institucionin	Hartimi i formularit të vetëvlerësimit për periudhën janar- Dhjetor 2022 dhe përcaktimi i performancës së institucionit	Drejtoria e Financës Grupi i punës	Janar 2023	
OBJEKTIVI 14: ANALIZA E BUXHETIT SI DHE MBYLLJA E PASQYRAVE FINANCIARE PËR VITIN USHTRIMOR 2022					
Nr.	Masat / proceset e planifikuara	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Institucioni/ Dr. Përgjegjës	Afate / komente	Realizimi i masës
14.1	Pasqyrat financiare për vitin 2022	Plotësimi i pasqyrave financiare për vitin 2022, sipas formatit standart të miratuar nga Ministria e Financës	Drejtoria e Financës	Shkurt 2023	
14.2	Inventarët fizikë dhe kontabël	Kryerja e inventarëve fizikë dhe kontabël për aktivet e institucionit	Drejtoria e Financës	Dhjetor 2023	
14.3	Amortizimi i pajisjeve	Amortizimi i pajisjeve objekt inventari të DNJF-së Pasqyrimi i vlerave në pasqyrat financiare të vitit ushtrimor paraardhës.	Drejtoria e Financës	Dhjetor 2023	

OBJEKTIVI 15: MIRATIM I I STRUKTURËS SË DREJTORISË SË NDIHMËS JURIDIKE FALAS					
Nr.	Masat / proceset e planifikuara	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Institucioni/ Dr. Përgjegjës	Afate / komente	Realizimi i masës
15.1	Miratimi i numrit të Punonjësve për vitin 2023		Ministria e Drejtësisë	Janar 2023	
15.2	Miratimi i Urdhrit të Kryeministrit për Ndryshimin e Strukturës dhe Organikës së Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas	Propozimi për ndryshimin e Strukturës (përcjellë shkresërisht në vitin 2022 nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas)	Kryeministri Ministria e Drejtësisë Ministria e Financave DAP	Janar 2023	
15.3	Ndryshimi i Rregullores së funksionimit të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas	Hartimi i rregullores	DNJF	Janar-Mars 2023	
15.4	Hartimi i përshkrimeve të reja të detyrave për çdo punonjës të DNJF sipas strukturës së re	Hartimi i përshkrimeve të punës	Njësia e Burimeve Njerëzore Ministria e Drejtësisë DAP	Janar-Qershor 2023	
15.5	Ngritja e Komisionit të Ristrukturimit	Ngritja e Komisionit dhe rishpërndarja e punonjësve ekzistentë sipas strukturës së re	DNJF DAP	Janar-Qershor 2023	
15.6	Rekrutimi i punonjësve për vendet vakante të krijuara si pasojë e ristrukturimit të institucionit	Shpallja e vendeve vakante në HRMIS Shpallja e vendeve vakante në administrata.al Dërgimi në DAP i përshkrimeve të punës të punonjësve sëbashku me kërkesën për shpalljen e vendeve vakante.	DNJF DAP	Janar-Dhjetor 2023	

Faqosja dhe shtypi: Gent Grafik
Në kopertinë: Image by kjpargeter on Freepik

